



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri  
Elektronike”**

**ofruar nga**

**Universiteti Privat “Albanian University”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Thoma Korini

Prof As. Genci Sharko

Nëntor, 2024

**Tabela Përmblyese Për Programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" ofruar nga Universiteti Privat "Albanian University"**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierive
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASh Nr. 411, datë 25.08.2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS nr.2600/1, dt.02.06.2021
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	UMASR Nr. 398, datë 28.10.2020
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Urdhër Nr. 380, datë 08.07.2016 VBA Nr. 36, datë 19.05.2017; VBA Nr. 83 datë 27.10.2018 (deri më 30.09.2023)
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike (4 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite ( ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7(shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a 2020-2021: 6 PAE/3 PAK v.a 2021-2022: 5 PAE/2 PAK v.a 2022-2023: 5PAE/3PAK
18	Numri i studentëve:	v.a 2020-2021:17 studentë v.a 2021-2022:22 studentë v.a 2022-2023 20 studentë
19	Komente / të tjera:	

## **PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti “Albanian University” (AU), është një Institucion privat i arsimit të lartë, i themeluar në vitin 2004 me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 197, datë 10.04.2004 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “UFO Dental””. Me VKM Nr. 603, datë 24.08.2011 është realizuar ndryshimi i emrit, ndërsa me Urdhërin e MAS Nr. 52, datë 05.02.2016 “Për riorganizmin institucional të Universitetit Privat “Albanian University” dhe Urdhërin e MAS Nr. 596, datë 21.12.2016 “Për miratimin e Statutit të Universitetit “Albanian University” është realizuar hapja e njësisë kryesore “Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomisë”.

Sipas strukturës dhe Statutit, të miratuara në vitin 2016, aktualisht Universiteti privat “Albanian University” përbëhet nga tre fakultete:

- Fakulteti i Shkencave Shoqërore
- Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike si njësi kryesore ku ky program studimi ofrohet, është i përbërë nga tre njësi bazë, përkatësisht:

- Departamenti i Art Dizajn
- Departamenti i Shkencave Ekonomike
- Departamenti i Inxhinierive

AU i nënshtrohet akreditimit të jashtëm periodik. Me vendim të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, përmes Vendim Nr. 55, datë 26.05.2023 AU i është dhënë një vlerësim pozitiv për cilësinë akademike me një kohëzgjatje prej 4 vitesh (deri më 25.05.2027).

Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” është licencuar përmes Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.411, datë 25.08.2011 si dhe është akredituar me Urdhër Nr. 380, datë 08.07.2016, VBA Nr. 36, datë 19.05.2017 dhe VBA Nr. 83 datë 27.10.2018 me vlefshmëri deri më 30.9.2023. Kohëzgjatja e tij normale është 2 vite dhe numri i krediteve të tij është 120 ECTS.

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm (RVJ) është hartuar në vijim të detyrimeve për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike”, ofruar aktualisht nga Universiteti privat “Albanian University”. Në hartimin e këtij Raporti, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) është mbështetur në dokumentacionin e Dosjes së Vetëvlerësimit të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit për këtë program studimi, në konstatimet, gjetjet dhe shënimet e mbajtura gjatë takimeve të zhvilluara gjatë vizitës në Institucion, si dhe në dokumentacionin shtesë të vënë në dipozicion nga Institucioni.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Mbështetur në VKM nr.109/2017, ASCAL ka përcaktuar kohën dhe grupet e vlerësimit të jashtëm për vlerësimin e programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike”. Bazuar në Urdhër nr. Nr.124, datë 10.10.2023 të ASCAL, “Për përcaktimin e ekspertëve që do të marrin pjesë në vlerësimin e jashtëm, akreditimin e programeve të studimit, aplikuar nga Universiteti Privat “Albanian University”, grupi i vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi përbëhet nga, Prof. Thoma Korini dhe Prof.As. Genci Sharko.

Gjatë procedurës, GVJ është asistuar nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, Alma Arapi.

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Tetor 2023 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti Privat “Albanian University” (AU), për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. AU, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB, dokumentacion ky i transferuar në sistemin AMS të ASCAL.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkuara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr.824, datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë” si dhe gjithë aktet e tjera nënligjore që kanë të bëjnë me organizmin e studimeve në institucionet e arsimit të lartë.

Gjatë vizitës së kryer në institucion, në datat 19 dhe 20 Dhjetor 2023, u zhvilluan një sërë takimesh mes grupit të vlerësimit të jashtëm dhe përfaqësuesve të AU. Takime ndër të cilat mund të përmendim atë me Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Përgjegjës të Departamentit të Inxhinierive, Grupin e Vlerësimit të brendshëm, stafin akademik, studentët, përfaqësues të Zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave, Zyrës së Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akadematike, Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, si dhe përfaqësues të Sekretarisë Mësimore. Gjithashtu u zhvillua edhe një vizitë e auditorëve, laboratorëve si dhe bibliotekës, shoqëruar me diskutime për elementë lidhur me këtë infrastrukturë. Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e syllabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kualifikimin e stafit akademik, etj. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet shtesë që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave të paraqitura. Në përfundim të analizës së materialeve të sipër cituara, GVJ hartoi raportin e mëposhtëm, i cili paraqet mendimet e ekspertëve të jashtëm mbi këtë program studimi duke paraqitur edhe disa rekomandime, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të programit.

## SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. **Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 83, datë 27.10.2018 janë [Ev.: <https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-27-tetor-2018>]:**

1. Institucioni, brenda vitit akademik 2018-2019, të rekrutojë staf të ri akademik me kohë të plotë, me grada e tituj, me qëllim uljen e ngarkesës mësimore të stafit akademik aktual të angazhuar në këtë program studimi dhe përfshirjen më të madhe të tyre në kërkim shkencor.

### II. **Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni**

Nga një analizë e dokumentacionit në dispozicion, diskutimeve në lidhje me këta elementë në institucion dhe një vlerësimi të detajuar GVJ është i mendimit se:

#### Rekomandimi 1:

GVJ konstatoi angazhim të institucionit për përmbushjen e këtij rekomandimi, duke shpallur dy herë në vit (në fillim të vitit akademik dhe përpara fillimit të semestrit të dytë) nevojat për staf të ri akademik specifikave të programit të studimi. GVJ vëren se ka një rritje të lehtë të personelit akademik efektiv të angazhuar në këtë program studimi, por që mbetet e kufizuar për shkak se kandidatët që plotësonin kriteret kanë qenë të paktë.

Megjithatë, duke iu referuar ngarkesës mësimore, vërehet se në një numër të konsiderueshëm rastesh **ka një mbingarkesë të personelit akademik efektiv** [Ev.: *Tabela Aneks RVB - MSc. IE (Tabela 4)*]. Kjo mbingarkesë për PAE tejkalon dhe shtesën maksimale të orëve suplementare prej 200 orësh. Konstatohet se ka dhe raste kur tejkalohej edhe shtesa prej 100 orësh të tjera që mund të akordohen në raste specifike, referuar Udhëzimit Nr.29, datë 10.09.2018 "*Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë*" dhe Udhëzimit Nr. 36, datë 23.11.2018 "*Disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë"*".

Mbetet detyrë e Institucionit të gjejë mekanizmat e duhur për rekrutimin e personelit akademik suplementar me qëllim reduktimin e ngarkesës mësimore në kufijtë e përcaktuar nga aktet nënligjore.

Përsa i përket përfshirjes më të madhe të personelit akademik në kërkim shkencor, GVJ konstatoi se ka një angazhim real në këtë drejtim, pasqyruar në numrin e botimeve, numrin e projekteve kërkimore dhe të shkëmbimit të fituara, numrin e projekteve të zbatuara dhe numrin e aktiviteteve të organizuara nga Departamentit të Inxhinierive, duke përmbushur këtë element të rekomandimit [Ev. *MSc. IE Tabela me të dhënat e kerkimit shkencor*].

Në këtë mënyrë, në global, GVJ konkludon se, rekomandimi i Bordit të Akreditimit **nuk është përmbushur plotësisht për pjesën që ka të bëjë me uljen e ngarkesës mësimore të stafit akademik aktual të angazhuar në këtë program studimi.**

Universiteti Privat "Albanian University", është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 28.10.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 177/34 Prot, datë 28.10.2024. Universiteti Privat "Albanian University", njofton në ASCAL më datë 04.11.2024, me anë të shkresës me Nr.384/1 Prot, datë 04.11.2024. Universiteti Privat "Albanian University", njofton në ASCAL ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike”**

**I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi I.1</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Universiteti “Albanian University”, rregullores së programit të studimit, GVJ vlerëson se programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike”, ofruar prej Departamentit të Inxhinierive është në përputhje me misionin e AU shprehur në statutin e institucionit dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare. GVJ vlerëson se programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” ruan dhe konsolidon vlerat akademike e kulturore kombëtare. Ai synon t’u japë studentëve një edukim cilësor, kontribut në kërkim të qëndrueshëm në përdorimin e arritjeve më të mira të shkencës.  <i>[Ev 1.2 Statuti Albanian University; 1.4.a Plani strategjik institucional 2017 – 2022; 1.4.c Strategjia per zhvillimin institucional AU - 2023 – 2028]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” është hartuar në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me politikat e zhvillimit të Institucionit, në lidhje me përgatitjen e profesionistëve në fushën e Inxhinierisë Elektronike  <i>[Ev: 1.2 Statuti Albanian University; 1.3 Rregullore Albanian University. 1.4.a Plani strategjik institucional 2017 – 2022.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në	Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit i cili ka si objektiva strategjike cilësinë dhe performancën akademike. Përbushja e misionit të AU planifikohet të realizohet edhe duke siguruar shumëllojshmëri të ofertave të formimit në përputhje me nevojat e zhvillimit perspektiv të vendit. Statuti i “Albanian University” përcakton qartë drejtimit prioritare akademike, ato

përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	përputhen me fushat e studimit të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike", Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamentit të Inxhinierive, prej nga varet programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike".  [Ev:1.4.a Plani strategjik institucional 2017 – 2022 1.4.b Plani i masave Rektorati 2020 – 2021 për realizimin e objektivave strategjike institucionale - 2017 – 2022; Evidencë 1.2 Statuti Albanian University].			
<b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" mbështetet në përvojën disavjeçare dhe praktikën më të mira, i hartuar edhe në mbështetje të strategjisë nëpërmjet objektivave kryesore, strukturës mësimore, programin e studimit etj.  [Ev. H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021.]			
<b>Konkluzione</b>	Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" ofruar nga njësi kryesore Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në "Albanian University" prej Departamentit të Inxhinierive, është në përputhje me interesat kombëtare, me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe me fushën e veprimtarisë së tij akademike.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një	Nga vlerësimi i dokumentacionit dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se AU ka përvojë dhe eksperiencë në fushën akademike, kapacitetet në infrastrukturë dhe struktura ndihmëse universitare. Personeli akademik efektiv (PAE) dhe me kontratë (PAK) i <b>Departamentit të Inxhinierive në vitin akademik 2022-2023</b>



<p>programi studimi në atë fushë.</p>	<p>përbëhet nga: 1 Profesorë te Asociuar, 7 Lektorë me gradën Doktor dhe 10 Asistent-Lektorë me gradën Msc., në total 18 PAE, ndërsa personeli akademik me kontratë (PAK) përbëhet nga: 1 Prof. Dr , 4 Profesorë te Asociuar dhe 12 Lektorë me gradën Doktor, 1 Msc në total 18 PAK.</p> <p>Përbërja e Departamentit të Inxhinierive, përgjegjës për këtë program studimi, paraqitet si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për vitin akademik 2018-2019: 19 PAE, me kualifikimin 8 Dr., dhe 11 Msc. (3 Dr. në proces) dhe 16 PAK, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 7 Prof. As., 6 Dr., dhe 2 Msc. (1 Dr. në proces);</li> <li>- Për vitin akademik 2019-2020: 16 PAE, me kualifikimin 7 Dr., dhe 9 Msc. (3 Dr. në proces) dhe 18 PAK, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 6 Prof. As., 9 Dr., dhe 2 Msc. (1 Dr. në proces);</li> <li>- Për vitin akademik 2020-2021: 15 PAE, me kualifikimin 7 Dr., dhe 8 Msc. (1 Dr. në proces) dhe 17 PAK, me kualifikimin 2 Prof. Dr., 5 Prof. As., 7 Dr., dhe 3 Msc. (2 Dr. në proces);</li> <li>- Për vitin akademik 2021-2022: 17 PAE, me kualifikimin 1 Prof. As., 7 Dr., dhe 9 Msc., dhe 19 PAK, me kualifikimin 2 Prof. Dr., 5 Prof. As., 11 Dr., dhe 1 Msc.</li> <li>- Për vitin akademik 2022-2023: 18 PAE, me kualifikimin 1 Prof. As., 7 Dr.(1 dr proc) , dhe 9 Msc., dhe 18 PAK, me kualifikimin 1 Prof. Dr., 4 Prof. As., 12 Dr., dhe 1 Msc.</li> </ul> <p><i>[Ev: 1.5 Përshkrimi i Laboratoreve të Departamentit të Inxhinierive;</i>  <i>4.2 CV stafi akademik MSc. IE - v.a 2022 - 2023;</i>  <i>Aneks tabela Tabcla 2- RVB - MSc. IE - 10.2023]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të</p>	<p>Njësia kryesore, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, ofron programe studimi në fushën e inxhinierisë elektronike që prej vitit 2011. Drejtimet kërkimore shkencore të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike janë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore. Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike”, i ofruar nga Departamenti i Inxhinierive, ka si fushë të përgjithshme fushën e inxhinierisë elektronike të përputhur me fushën akademike dhe shkencore të njësisë kryesore.</p>

programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<i>Në përputhje me Udhëzimet MAS Nr. 31. datë 15.11.2022 mbi kodifikimin e programeve të studimit, Institucioni është angazhuar në përgatitjen e kodifikimit por nuk e ka përfunduar atë.</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Bazuar në dokumentacion dhe takimet e realizuara me stafin e angazhuar për këtë program studimi GVJ konstaton se fusha kërkimore e tyre përputhet me natyrën inxhinerike të aplikuar për këtë program studimi. Kjo i jep mundësi stafit të realizojë në mënyrë më profesionale programin e lëndëve dhe ta përmirësojë vit pas viti duke marrë feedback edhe nga studentët.  <i>[Ev 1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022; H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021 Aneks Tabelat/Tabela 4]</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	N/A			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtjshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Departamenti i Inxhinierive ofron për studentët e diplomuar trajnime të mëtjshme profesionale			
<b>Konkluzione</b>	<i>Institucioni disponon infrastrukturën dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin me cilësi të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike". Institucioni është angazhuar në përgatitjen e kodifikimit por nuk e ka përfunduar atë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Ndarja e detyrave mes njësive e personelit përcaktohet nga institucioni në rregulloren tij dhe në rregulloren e njësisë kryesore. Nga vlerësimi rezulton se Departamenti i Inxhinierive ofron programin e studimit Master i Shkencave “Inxhinieri Elektronike” në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha strukturat e institucionit si: Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, Sekretaria mësimore, Arkiva dhe Protokoli, Zyra e Burimeve Njerëzore, Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, Zyra e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, etj. dhe departamentet e tjera në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike të “Albanian University”, gjë që çon në përmirësimin e efektivitetit të këtij programi studimi.</p> <p><i>[Ev: 1.3 Rregullore Albanian University; 6.9.e Rezultatet e pyetësorit drejtuar personelit akademik për mësimin online v.a. 2020 - 2021 - Sem. I; 6.9.g Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. II - v.a. 2021 – 2022; 6.8.d Fokus Grupe – 2022; Vizita në Institucion, takimi me përgjegjësën e departamentit]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Universiteti “Albanian University” ka bashkëpunime ndër-institucionale me institucione shtetërore dhe IAL brenda vendit, si dhe me kompani dhe zyra, pjesë e komunitetit të biznesit ose tregut të punës. Realizimi i praktikave profesionale mbetet një ndër bashkëpunimet kryesore me këto institucione. Me anë të këtyre bashkëpunimeve AU synon gjithashtu krijimin e lidhjeve midis universitetit dhe aktorëve të tregut të punës në funksion të punësimin të studentëve, por edhe për të qenë më pranë nevojave të tregut të punës dhe reflektimit të tyre në programin e studimit. Departamenti i Inxhinierive ka nënshkruar mbi 30 marrëveshje specifike për programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike”.</p> <p><i>[Ev: 1.1.d Raporti Sem. I - DI - v.a. 2021 - 2022.. Aneks tabela - RVB - MSc. IE - 10.2023]</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton se procedura e zhvillimit të praktikave profesionale është e rregulluar nëpërmjet udhëzuesit për zhvillimin e praktikës. Në të janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen, ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësive të ndryshme të përfshira në këtë proces. Departamenti i Inxhinierive ka nënshkruar mbi 30 marrëveshje specifike për programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike”.</p> <p><i>[Ev: 1.1.d Raporti Sem. I - DI - v.a. 2021 – 2022; Aneks tabela - RVB - MSc. IE - 10.2023]</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se procedura e zhvillimit të praktikave profesionale është e rregulluar nëpërmjet udhëzuesit për zhvillimin e praktikës. Në të janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen, ashtu edhe roli i aktorëve dhe njësive të ndryshme të përfshira në këtë proces. Departamenti i Inxhinierive ka nënshkruar marrëveshje specifike për programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike”.</p> <p><i>[Ev: 1.1.d Raporti Sem. I - DI - v.a. 2021 – 2022; Aneks tabela - RVB - MSc. IE - 10.2023]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Departamenti i Inxhinierive dhe njësia kryesore Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në AU ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Institucione të ndryshme të Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësojnë realizimin e objektivave të programit të studimit.</i></p> <p><i>DI falë bashkëpunimeve me entet vendase mundëson zhvillimin korrekt të praktikave profesionale të studentëve, në përputhje me profilin e studimeve të tyre në ciklin e parë..</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” organizohet në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje normale 2 vite dhe në total 120 kredite.</p> <p>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021 VKM nr. 41, datë 24. 1. 2018; VKM Nr. 879, datë 18.12.2019]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të</p>	<p>Programi i studimit nëpërmjet moduleve dhe lëndëve të ofruara, krijon mundësinë e formimit të shprehive të veçanta.</p> <p>Gjithashtu programi synon që studentët të jenë në gjendje të përcaktojnë zgjidhje të proceseve teknologjike në fushën e inxhinierisë elektronike duke shfrytëzuar analiza dhe kritere të aplikuara në këtë fushë për sisteme të tilla. GVJ konstaton se objektivat formuese përmbushen mirë.</p> <p>Studimi i tregut i kryer ka evidentuar disa specialitete për të cilat formohen studentët e këtij programi.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe intervistave gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se programi i studimit thëllon njohuritë e studentëve në fushën e Inxhinierisë Elektronike, ku një vend të konsiderueshëm në program zë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve të fushës së elektronikës.</p> <p>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021;</p>

paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023; <i>Vizita në Institucion, takimi me stafin akademik</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	GVJ konstaton se në kurrikulen dhe në planin mesimor të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” janë përcaktuar ngarkesa mësimore për praktikën profesionale prej 12 ETCS dhe teza e diplomës 18 ETCS.  <i>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021;</i>
<b>Kriteri 4.</b> Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Master i Shkencave në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	NA
<b>Kriteri 5.</b> Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	NA
<b>Kriteri 6.</b> Forma e organizimit të studimeve,	NA

<p>pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	
<p><b>Kriteri 7.</b> Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” në Departamentin e Inxhinierive ka një ngjashmëri mbi 70 % me programe studimi të njëjtës fushë dhe emertesë me Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike pranë Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit në Universiteti Politeknik i Tiranës.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Institucioni është angazhuar në përgatitjen e kodifikimit të programit të studimit dhe kodifikimit të lëndëve <b>por ky proces nuk është përfunduar.</b></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Ky program nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas apo të huaj.</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi. Ai është i organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në kredite sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i></p>

	<i>Institucioni është angazhuar në përgatitjen e kodifikimit të lëndëve por ky proces nuk është përfunduar.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.2</b>																																																																										
<b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</b>																																																																										
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>																																																																									
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” është licencuar përmes Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.411, datë 25.08.2011 si dhe është akredituar me VBA Nr. 41, datë 19.05.2017 dhe VBA Nr. 41, datë 13.07.2018 me vlefshmëri deri më 30.9.2023.</p> <p>Stafi akademik i DI është një kombinim i pedagogëve me tituj dhe me ekperiencë si dhe me pedagogë të ftuar që zotërojnë një punë në ushtrimin e profesionit të tyre</p> <p><b>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike për tre vite akademike ka në përbërjen e tij:</b></p>																																																																									
	<table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">FSHAE</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr</td> <td>-</td> <td>4</td> <td>1</td> <td>6</td> <td>1</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>3</td> <td>11</td> <td>3</td> <td>11</td> <td>3</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>Dr/Phd</td> <td>16</td> <td>14</td> <td>16</td> <td>21</td> <td>16</td> <td>22</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>18</td> <td>13</td> <td>17</td> <td>10</td> <td>19</td> <td>6</td> </tr> <tr> <td><b>Gjithsej</b></td> <td><b>37</b></td> <td><b>42</b></td> <td><b>37</b></td> <td><b>48</b></td> <td><b>39</b></td> <td><b>42</b></td> </tr> </tbody> </table>	FSHAE	2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	Prof. Dr	-	4	1	6	1	5	Prof. Asoc.	3	11	3	11	3	9	Dr/Phd	16	14	16	21	16	22	Msc.	18	13	17	10	19	6	<b>Gjithsej</b>	<b>37</b>	<b>42</b>	<b>37</b>	<b>48</b>	<b>39</b>	<b>42</b>	<p><b>Departamenti i Inxhinierive për tre vite akademike ka në përbërjen e tij:</b></p> <table border="1"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit</th> <th colspan="2">2020-2021</th> <th colspan="2">2021-2022</th> <th colspan="2">2022-2023</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>						Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2020-2021		2021-2022		2022-2023		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK						
FSHAE	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																																																					
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																				
Prof. Dr	-	4	1	6	1	5																																																																				
Prof. Asoc.	3	11	3	11	3	9																																																																				
Dr/Phd	16	14	16	21	16	22																																																																				
Msc.	18	13	17	10	19	6																																																																				
<b>Gjithsej</b>	<b>37</b>	<b>42</b>	<b>37</b>	<b>48</b>	<b>39</b>	<b>42</b>																																																																				
Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2020-2021		2021-2022		2022-2023																																																																					
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK																																																																				



Prof. Dr	-	2	-	2	-	1
Prof. Asoc.	-	5	1	5	1	4
Dr/Phd	7	7	7	11	7	12
Msc.	8	3	9	1	9	1
<b>Gjithsej</b>	<b>15</b>	<b>17</b>	<b>17</b>	<b>19</b>	<b>18</b>	<b>18</b>

*Aneks tabela Tabcla 6 RVB - MSc. IE - 10.2023*

<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>GVJ vlerëson se praktikat mësimore zhvillohen në afate dhe me partnerët që AU ka marrëveshje bashkëpunimi dhe nën drejtimin e një pedagogu te caktuar nga Departamenti të një grupi studentësh prej 20 vetë.</p> <p>Gjithashtu, në kuadër të marrëveshjeve për praktikat mësimore institucioni pritës cakton një mbikqyrës të praktikës.</p> <p>Departamenti i Inxhinierive ka përcaktuar një akademik (laborant), i cili mbikqyr mbarëvajtjen e punës dhe mbajtjen në punë të laboratorëve.</p> <p>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.2 Miratim udhëheqës praktika mësimore MSc. - v.a. 2021 – 2022]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Përgjegjësia për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij është e përgjegjësit të departamentit.</p> <p>Koordinatorët e grupeve mësimore koordinojnë përmbajtjen e syllabuseve të lëndëve të grupit mësimor, rishikimin etj., si dhe janë përgjegjës për ecurinë e praktikave profesionale.</p> <p>Koordinatori për studentët koordinon marrëdhëniet mes studentëve dhe stafit, kryen këshillimin e studentëve në lidhje me kurrikulën dhe raporton për problematika të studentëve në departament dhe tek përgjegjësi i departamentit.</p> <p>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; 2.3 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021; 2.4.a Koordinatorët e gruplëndëve DI; 2.4.b Koordinatorët e programeve të studimit DI]</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Në programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" zhvillon mësim me një staf pedagogësh të kualifikuar të cilët kanë eksperiencë akademike dhe profesionale me titujt shkencorë.. Departamenti i Inxhinierive plotëson kriteret ligjore duke</i></p>

	<i>angazhuar per vitin Akademik 2022-2023, 18 pedagogë si staf akademik efektiv PAE dhe 18 si staf akademik me kontratë PAK.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Departamenti i Inxhinierive disponon dhe ka vënë në dispozicion të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: Rregulloren, programin mësimor, syllabuset, orarin, ngarkesën e stafit akademik, etj. Dosja e plotë e çdo viti mbahet në departamentin përkatës.</p> <p><i>[Ev: 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023; 4.1.e Ngarkesa mësimore stafi akademik MSc. IE - v.a. 2022 – 2023]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	<p>GVJ konstaton se plani mësimor përmban informacionet për ngarkesën mësimore, orët në auditor dhe jashtë auditorit. Në syllabuset e lëndëve jepet informacion në lidhje me temat mësimore në leksione dhe në seminare, orët faktike për secilën prej temave, detyrimet lidhur me lëndën, etj.</p> <p>Frekuentimi, ndjekja e programit dhe mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohen në rregulloren e programit dhe syllabuset.</p> <p>Ky program studimi ka një kohëzgjatje normale 2 vite dhe në total 120 kredite organizuar ne 4 semestra, me kohë të plotë.</p> <p>A. Lëndë Bazë: 10 ECTS / 8.33% (sipas VKM 5%-10%);  B. Lëndë Karakterizuese: 65 ECTS / 54,1% (sipas VKM 50%-60%);  C. Lëndë Ndërdisciplinore: 15 ECTS / 12,5% (sipas VKM 12%-20%);  D. Lëndë Plotësuese (Praktika): 12 ECTS / 10% (sipas VKM 10%);  E. Detyrime Përmbyllëse: 18 ECTS / 15% (sipas VKM 10%- 15%).</p> <p><i>[Ev: 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021;</i></p>

	<p>2.1.c Miratim ore per ECTS - programe DI - VSA. 13, dt. 07.04.2021]</p> <p>H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021;</p> <p>Vizita në Institucion, takimi me përgjegjës in e departamentit]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se Rregullorja e programit të studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve</p> <p>Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit jepen në Rregulloren mësimore. Kandidatët fitues përzgjidhen nga Komisioni <i>Ad-Hoc</i>, i propozuar nga Departamenti dhe i miratuar nga Dekanati. Transferimi i studentëve në programe studimi të njëjta ose të afërta, vendase ose të huaja, dhe ekuivalentimi i studimeve rregullohen me dokumentin e Rregullores së regjistrimeve dhe transferimeve.</p> <p>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021;</p> <p>2.5 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve - VS 25 - dt. 25.06.2020]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se syllabuset e lëndëve janë të paraqitura në strukturë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi.</p> <p>Programet lëndore hartohen nga titullari i lëndës, sipas modelit të paraqitur në VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, e ndryshuar në të përfshihen për praktikat, leksionet, seminarët apo orët e laboratorit dhe komponentët e tjera. Në fillim të çdo semestri pedagogu i njëj studentët me programin lëndor dhe veprimtaritë e përfshira në të, me detyrimet dhe përgjegjësitë, me format e vlerësimit dhe provimin final.</p> <p>[Ev: 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021;</p> <p>2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021;</p> <p>2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive kujdeset që në mënyrë periodike të rishikojë syllabuset e programit të studimit për të cilin ai është përgjegjës. Ky rishikim është kryer në mënyrë periodike në vitet 2018 deri në vitin 2023.</p> <p>[Ev: 2.7.a Rishikime syllabuse - v.a. 2018 - 2019</p> <p>2.6 Procedura e rishikimit të kurrikulave MSc. – 04.2021.</p>

arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	2.7.e Rishikime syllabuse - v.a. 2022 – 2023]			
<b>Konkluzione</b>	Syllabuset e lëndëve të programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” përmbajnë informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra sipas disiplinave përkatëse, krediteve dhe orëve në auditor dhe jashtë auditorit. Anëtarët e stafit të Depratmentit të Inxhinierive përgjegjës për syllabuset kujdesen për përditësimin e kurrikulës dhe syllabuseve të lëndëve përkatëse.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.4</b>	
<b>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi i programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” është në përputhje me fushën akademike të tij. Përmbajtja e veprimtarive mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike. GVJ vlerëson se ky program studimi mundëson përgatitjen e studentëve me aftësi teorike dhe praktike, një element mjaft i rëndësishëm ky për t’u përballur me tregun e punës pas diplomimit të tyre apo thellimit të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme në fushën e elektronikës dhe të telekomunikacionit.  [Ev: 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023]
<b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se mundësohet arritja e objektivave formues të programit të studimit në Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” dhe rezultateve të pritshme të të nxënit, aftësimin profesional dhe kërkimit shkencor.  [Ev: 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023 Vizita në Institucion, takimi me stafin e programit]

<p>të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët janë në përputhje me profilin e programit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” dhe rrjedhimisht të domosdoshme për formimin e specialistëve në këtë fushë studimi. Nga vizita në institucion, GVJ konstaton se raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit. Lëndët janë të organizuara në aktivitete formuese Leksion/Ushtrime (seminar). Në secilën prej tyre ka aktivitete formuese teorike dhe praktike.</p> <p>Gjate 2 viteve të studimit programi i studimit ka (në auditor):</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Leksione - 375 orë,</li> <li>• Seminare (Ushtrime) Detyra kursi · 405 orë,</li> <li>• Laboratore-301 orë,</li> <li>• Praktike mësimore – 240 orë.</li> <li>• Temë diplome - 36 orë.</li> </ul> <p>Gjithsej 706 orë në auditor dhe 794 orë jashtë auditorit në total 1500 përgjatë dy viteve.</p> <p><i>[Ev: 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023 Vizita në Institucion, takimi me stafin e programit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe formimin e specialistëve të aftë në fushën e inxhinierisë elektronike dhe të telekomunikacionit.</p> <p>Njohuritë e marra gjatë studimeve në këtë program studimi i mundësojnë studentit transferimin e studimeve në programe të ngjashme brenda dhe jashtë vendit, si dhe punësimin e tij në përputhje me fushën e studimit në ente publike dhe private kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Sasia e orëve në auditor (706 orë) për përgatitjen praktike (Seminare, laboratorë, projekte praktikë, etj) është 405 orë, nga 375 (53,1%) orë totale për përgatitjen teorike (orët e leksioneve), ose orët në auditor për përgatitjen praktike zënë rreth 57,3 % të orëve totale në auditor. GVJ gjykon që raporti i tyre është në përputhje dhe mjaftueshëm për ciklin e dytë të studimeve.</p> <p><i>[Ev: 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023 RVB - MSc. IE - 10.2023]</i></p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion GVJ konstaton se syllabuset rishikohen në fillim të vitit akademik për të futur literaturat e reja, të cilat duhet të jenë të 5 viteve të fundit. Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstatoi në përgjithësi në to janë pasqyruar përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p> <p><i>[Ev: 2.7.a,b,c,d,e Rishikime syllabuse - v.a. 2018 – 2023 2.8 Kërkesë pasurimi i bibliotekës v.a. 2021 – 2022]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Bazuar në lëndët e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përkatëse, evidentohet se programi i studimit ka përmbajtje didaktike dhe profesionale formuese dhe garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave që synon programi dhe niveli Master i Shkencave. Në të përfshihen lëndë si “Teoria e Radiofrekuences”, Teoria e rrjetave të avancuara”, “Sistemet me mikroprocesor”, “Algoritëm dhe programim i avancuar” etj të cilat garantojnë këtë përmbajtje didaktike.</p> <p><i>[Ev: 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” u jep mundësi studentëve të pozicionohen në karrierën e tyre të ardhshme profesionale. Nga shqyrtimi dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se programi i studimit, duke kombinuar teorinë me praktikën, siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional në fushën e Shkencave të Inxhinierisë Elektronike dhe të Komunikacionit.</p> <p><i>[Ev: 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023]</i></p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Përmbajtja dhe Organizimi në module/lëndë në Programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike”, krijon mundësinë e formimit profesional të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës duke mundësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës.</i></p>

	<i>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstatoi në përgjithësi në to janë pasqyruar përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ vlerëson se Departamenti i Inxhinierive vlerëson periodikisht zhvillimet e detajuara të tregut për të përmirësuar kurrikulën e programit të studimit të ofruar në përputhje me mundësitë e punësimit të ofruara në nivel kombëtar e ndërkombëtar.  <i>[Ev: 2.9.b Raport mbi studimin e tregut - DI - Dhjetor 2021]</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimin të programit të studimit.	GVJ vlerëson se nga Institucioni bëhen përpjekje për të mbështur studentët për tu përfshirë në strukturat vendimarrëse të tij. Ai nxit që në mbledhjet e Departamentit, Senatit Akademik përfaqësuesi i studentëve nga Këshilli Studentor dhe çdo student apo i diplomuar të marrë pjesë në diskutimet dhe konsultimet për përmirësimin e programit të studimit.
<b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat	GVJ vlerëson se nga Institucioni mbahen kontakte të vazhdueshme me aktorë të tregut të punës për të përmirësuar kurrikulën e programit të studimit nëpërmjet ngritjes së Grupeve të Ekspertëve në

<p>programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>kuader të rishikimit të kurrikulës së programit të studimit master i shkencave. Grupet janë të përbëra prej 5 anëtarësh. Në të përfshien petagogë të brendshëm , te ftuar si edhe nga komuniteti i biznesit.</p> <p><i>[Ev: 2.10 Ngritja e GE për rishikimin e kurrikulave MSc. – 04.2021]</i></p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Departamenti i Inxhinjerive dhe anëtarët e stafit të tij nxisin përfshirjen e studentëve dhe institucioneve partnere në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara, duke dëshmuar një përmirësim të vazhduar të ofertës së tij akademike. Në riorganizimin e tij kontribut kanë dhënë të gjithë grupet e interesit duke shprehur qartas mendimin e tyre</i></p> <p><i>Programi i studimit Master në “Inxhinieri Elektronike” është rishikuar duke bërë edhe përmirësime.</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi II.6</b> <b>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” është konceptuar në harmoni me strategjinë e institucionit dhe statutin e “Albanian University” i cili përcakton qartë drejtimit prioritar të kërkimit shkencor në përputhje me fushat e studimit të programit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” të Departamentit të Inxhinierive.</p> <p><i>[Ev: 1.4.a Plani strategjik institucional 2017 – 2022</i> <i>1.4.b Plani i masave Rektorati 2020 – 2021 për realizimin e objektivave strategjike institucionale - 2017 – 2022;</i> <i>Evidencë 1.2 Statuti Albanian University</i> <i>H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021].</i></p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>GVJ kostaton se brenda Departamentit të Inxhinjerive dhe nga bashkëpunimi midis njësive kryesore të AU ekziston një bashkëpunim i mirë në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Departamentit të Inxhinjerive nxit dhe ka një rol aktiv në drejtim të bashkërendimit dhe administrimit të veprimtarisë kërkimore. Në këtë aspekt janë ndërmarrë një seri nismash që kanë ndikim pozitiv si në zhvillimin e kapaciteteve të stafit akademik por edhe tek studentet e këtij programi studimi. Nga evidencat shihen shëmbuj të mirë të mbështetjes së stafit akademik në pjesëmarrje në veprimtari kërkimore shkencore.</p> <p>Mënyra e realizimit të procesit mësimor dhe autonomia që secili pedagog ka në drejtim të realizimit të programit mësimor tregon se kryhen duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit</p> <p><i>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021].</i>  <i>[EV: 1.1.d Raporti Sem. I - DI - v.a. 2021 - 2022].</i>  <i>[EV: 3.8.d Axbenda - Konferenca e IV - IIST – 2022].</i></p>																																			
<p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Departamenti i Inxhinjerive që prej vitit 2019 dhe në vijimësi ka organizuar konferencën IIST ku studentët nxiten të marrin pjesë me projekte dhe studime në bashkëpunim dhe nën udhëheqjen e stafit akademik të njësisë bazë. Studentët marrin pjesë në forume për të shkëmbyer idetë e tyre.</p> <p><i>[Ev: 3.8.d Axbenda - Konferenca e IV - IIST – 2018-2022</i>  <i>3.9.b Programi Forumi II Studentor “Transformimi digjital në kohën e sfidave” - 17.05.2022].</i></p>																																			
<p><b>Kriteri 4.</b> Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>GVJ konstaton se të ardhurat buxhetore në pesë vitet e fundit janë si më poshtë.</p> <table border="1" data-bbox="454 1503 1337 1924"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Të ardhurat</th> <th>2018-2019</th> <th>2019-2020</th> <th>2020-2021</th> <th>2021-2022</th> <th>2022-2023</th> </tr> <tr> <th>%</th> <th>%</th> <th>%</th> <th>%</th> <th>%</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Pushteti qëndror/ vendor</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Grantet për kërkim dhe kontratat</td> <td>0</td> <td>0.4</td> <td>0.8</td> <td>1.5</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Tarifat për dhe gjatë shkollimit</td> <td>98.9</td> <td>98.4</td> <td>98.4</td> <td>97.1</td> <td>98.6</td> </tr> <tr> <td>Sponsorizimet</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>0</td> </tr> </tbody> </table>	Të ardhurat	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022	2022-2023	%	%	%	%	%	Pushteti qëndror/ vendor	0	0	0	0	0	Grantet për kërkim dhe kontratat	0	0.4	0.8	1.5	0	Tarifat për dhe gjatë shkollimit	98.9	98.4	98.4	97.1	98.6	Sponsorizimet	0	0	0	0	0
Të ardhurat	2018-2019		2019-2020	2020-2021	2021-2022	2022-2023																														
	%	%	%	%	%																															
Pushteti qëndror/ vendor	0	0	0	0	0																															
Grantet për kërkim dhe kontratat	0	0.4	0.8	1.5	0																															
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	98.9	98.4	98.4	97.1	98.6																															
Sponsorizimet	0	0	0	0	0																															

	Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)	0	0	0	0	0
	Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, rezidencat, etj.)	1.1	1.2	0.8	1.4	1.4
	<b>Shuma</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>
	<p><i>GVJ konstaton se deri më tani institucioni ka siguruar në vazhdimësi mbështetje financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit por mbështetja financiare për kërkimin shkencor mbetet relativisht e vogël nga institucioni dhe të ardhurat nga aktivitetet e ndryshme. Balancet financiare mbahen në nivel nivel institucioni por jo në nivelin e njësisë bazë kjo vështirëson vlerësimin e fondit të kërkimit shkencor.</i></p> <p>[Ev.: Takime në institucion; RVB; Tabela Aneks RVB - MSc. IE (Tabela 18)]</p>					
<b>Konkluzione</b>	<p><i>GVJ konstaton se brenda Departamentit të Inxhinjerive orientohet drejt bashkëpunimi midis njësive kryesore dhe brenda AU ekziston një bashkëpunim i mirë në lidhje me mësimdhënien dhe kërkimin shkencor.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se deri më tani institucioni ka siguruar në vazhdimësi mbështetje financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit por mbështetja financiare për kërkimin shkencor mbetet relativisht e vogël nga institucioni dhe të ardhurat nga aktivitetet e ndryshme. Balancet financiare mbahen në nivel nivel institucioni por jo në nivelin e njësisë bazë kjo vështirëson vlerësimin e fondit të kërkimit shkencor.</i></p>					
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	X	

<b>Standardi II.7</b>	
<b>Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për	Departamenti i Inxhinjerive dhe AU nxit dhe mbështet projektet kërkimore dhe ka bërë një sërë marrëveshesh me institucione të ndryshme kërkimore për bashkëpunim në punë kërkimore shkencore duke i dhënë përparësi ndërkombëtarizimit të universitetit.

<p>realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive ka aplikuar në projektet e PKKZH, Tubitak dhe europiane (Erasmus+ dhe Horizon) ku janë inkurajuar të marrin pjesë anëtarët e departamentit dhe studentët e programit të studimit.</p> <p>AU ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me 14 universitete partnere Evropiane.</p> <p><b>GVJ vlerëson se AU duhet të shtojë përpjekjet për shtimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadrin e bashkëpunimit evropian.</b></p> <p>[Ev.: 1.1.d Raporti Sem. I - DI - v.a. 2018 - 2022. RVB Tabela 5].</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse angazhohet për t’iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive ku zhvillohet programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” i përgjigjet kërkesave për projekte me karakter kërkimor shkencor. Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve në AU bashkëpunon me anëtarët e departamentit për të aplikuar në projekte kryesisht në programet e Bashkimit Evropian (Erasmus + KA2, Horizon2020 etj.).</p> <p>[Ev.: 1.1.d Raporti Sem. I - DI - v.a. 2018 - 2022. RVB Tabela 5].</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>GVJ konstaton se stafi akademik dhe studentët janë inkurajuar të marrin pjesë në aktivitetet shkencore të organizuara nga AU si: konferenca IIST ku studentët nxiten të marrin pjesë me preyantime; forumi “Transformimi digjital në kohën e sfidave” si edhe “Standardization, Prototypes and Quality: A Means of Balkan Countries Collaboration”· 2018.</p> <p>[Ev: 1.1.d Raporti Sem. I - DI - v.a. 2018 – 2022 3.8.d Axbenda - Konferenca e IV - IIST – 2018-2022 3.9.b Programi Forumi II Studentor “Transformimi digjital në kohën e sfidave” - 17.05.2022].</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Ky program studimi është në përputhje me kërkesat e tregut ai përgatit kuadro në fushën e elektronikës dhe të zhvillimeve të reja në përputhje me nevojat dhe prioritet kombëtare.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” nuk bën pjesë në profesionet e rregulluara, por ai</p>

rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	përgatit profesionistë në fushën e inxhinjerisë Elektronike. GVJ vlerëson se nga Institucioni mbahen kontakte të vazhdueshme me aktorëve të tregut të punës për të përmirësuar kurikulën e programit të studimit.  <i>[Ev: 2.10 Ngritja e GE për rishikimin e kurrikulave MSc. – 04.2021]</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> ).	Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” nuk bën pjesë në profesionet e rregulluara.			
<b>Konkluzione</b>	<i>Departamenti i Inxhinierive dhe AU nxit dhe mbështet projektet kërkimore dhe ka bërë një sërë marrëveshesh me institucione të ndryshme kërkimore për bashkëpunim në punë kërkimore shkencore duke i dhënë përparësi ndërkombëtarizimit të universitetit. GVJ vlerëson se AU duhet të shtojë përpjekjet për shtimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadrin e bashkëpunimit evropian. GVJ konstaton se stafi akademik dhe studentët janë inkurajuar të marrin pjesë në aktivitetet shkencore të organizuara nga AU në bashkëpunim me partnerë të tjerë.</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se personeli akademik i programit zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale, vizita studimore, etj. Gjithashtu Departamenti i Inxhinierive organizon orë të hapura me ekspertë te fushës së elektronikës .</p> <p><i>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023; 1.1.d Raporti Sem. I - DI - v.a. 2021 – 2022]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave “Inxhinieri Elektronike” merr pjesë në trajnimet e orientuara në aspektet didaktike të mësimdhënies të organizuara nga AU. Gjithashtu gjatë punës me studentët ata nxiten të përdorin metoda inovative të mësimdhënies. Personeli akademik merr në konsideratë nevojat e studentëve dhe bashkëpunon me ta për të ofruar një eksperiencë mësimdhënie-mësimnxënie sa më të mirë. Personeli akademik përdor sistemin e Office 365 si forma inovative të mësimdhënies.</p> <p><i>[Ev: 3.1.c Axhenda e trajnimeve të stafit akademik - v.a. 2022 – 2023. Vizita në Institucion, takimi me stafin e programit]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstaton se “Albanian University” ofron kushte dhe infrastrukturë të mirë për procesin e mësimdhënies, mbështet personelin akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike si dhe përditësimet e metodave të mësimdhënies, në përputhje edhe me objektivat dhe misionin e institucionit. Në funksion të programit të studimit janë laboratorët e DI, broshurat informuese, guida për studentët.</p>

	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se mjediset ku zhvillohet mësimi i programit të studimit Ciklit të dytë Master i Shkencave “Inxhinieri Elektronike” mundësojnë për personelin akademik përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe të ndryshme pedagogjike.</p> <p>Mjediset e mësimdhënies janë të paisura me projektorë dhe lidhje wireless.</p> <p><i>[Ev: 3.1.c Axxhenda e trajnimeve të stafit akademik - v.a. 2022 – 2023.</i></p> <p><i>Vizita në Institutcion, takimi me stafin e programit]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënive të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>GVJ pas analizimit të CV-ve të personelit akademik konstaton se personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” zotëron përgatitje dhe kompetenca profesionale në mësimdhënie dhe në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve.</p> <p>Nga anketimi i studentëve lidhur me procesin mësimor gjatë semestrit të parë të vitit akademik 2021-2022 ku morën 345 studentë për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, 216 studentë nga Departamenti i Inxhinierive. Nga rezultatet e pyetjes që vlerëson infrastrukturën evidentohet se institucioni ofron mjedise dhe infrastrukturë nxitëse për zhvillimin e programeve të studimit.</p> <p>Vlerësimi për stafin administrativ është pozitiv çka tregon një komunikim dhe bashkëpunim korrekt midis stafit dhe studentët.</p> <p><i>[Ev: 1.5 Përshkrimi i Laboratoreve të Departamentit të Inxhinierive.</i></p> <p><i>6.9.g Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. II - v.a. 2021 – 2022</i></p> <p><i>4.2 CV stafi akademik MSc. IE - v.a 2022 - 2023]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar</p>	<p>GVJ konstaton se format e metodat e mësimdhënies vlerësohen nga përgjegjësi i Departamentit të Inxhinierive dhe studentët, nëpërmjet komunikimit direkt me pedagogun apo përgjegjësin e njësisë bazë, ka mendime që shprehen nga përfaqësuesi i studentëve në mbledhje të njësisë bazë etj. Pyetësorët e hartuar në mënyrë periodike janë një mënyrë tjetër vlerësimi për metodat e mësimdhënies.</p> <p><i>[Ev: 6.9.g Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. II - v.a. 2021 – 2022;</i></p> <p><i>3.3 Shembull pyetësori në MF - MSc. IE - Viti I - Sem. I.</i></p>

mendimet e sugjerimet e tyre.	<i>Vizita në Institucion, takimi me stafin e programit]</i>		
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	<p>NJBSC përgatit raportin e vlerësimeve periodike dhe i vë në dispozicion të strukturave drejtuese, pedagogëve dhe palëve të tjera të interesuara. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë përpunohen dhe përmbledhen në një raport. Këto rezultate raportohen me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p> <p>Gjithashtu, AU nxit shembuj të praktikave më të mira, inkurajon dhe motivon stafin akademik për të përmirësuar më tej mësimdhënien duke organizuar aktivitete të ndryshme trajnimi, leksione të hapura dhe seminare me profesorë të ftuar.</p> <p>Departamenti i Inxhinierive është i përfshirë në projekte të ndryshme ndërkombëtare që AU ka me universitete ndërkombëtare, përmes të cilave motivon stafin të marrë pjesë në programet e mobilitetit si Erasmus+, KAI ose KA2, për të përmirësuar aftësitë e tyre mësimdhënëse.</p> <p><i>[Ev: 6.9.g Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. II - v.a. 2021 – 2022]</i></p>		
<b>Konkluzione</b>	<i>Albanian University kujdeset në vazhdimësi për vlerësimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Departamenti i Inxhinierive nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshtatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët.</i>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e	Mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive janë pjesë edhe e syllabuseve të cilat së bashku me rregulloren u bëhen të njohura

<p>vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Provimi përfundimtar 60 pikë (60%);</li> <li>• Provimi i ndërmjetëm 20 pikë (20%);</li> <li>• Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive në seminare, punë laboratorike, detyra/projekte kursi 20 pikë (20%).</li> </ul> <p>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023 3.4.b Manuali i provimeve online 2020 – 2021]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga takimi me studentët, GVJ konstaton se personeli akademik, në fillim të çdo lënde informon studentët për metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore dhe atë të programit.</p> <p>Rregullat e provimeve, pikët nga testimet gjatë vitit, për detyrat, projektet, aktivizimin në seminare dhe format e të tjera të vlerësimit janë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve, që njihen nga studentët.</p> <p>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023; Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të dijeve gjatë zhvillimit të kursit teorik dhe praktik të një lënde janë: Provimi i ndërmjetëm, niveli i pjesëmarrjes në seminare, detyra e kursit (projekte), provimi përfundimtar.</p> <p>Para provimit pedagogu informon studentët sa pikë kanë fituar gjatë kontrolleve gjatë vitit dhe nëse kanë të drejtë të futen në provim. Ai informon studentët gjithashtu edhe për kriteret që do të bëhet vlerësimi përfundimtar.</p> <p>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023; Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit]</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p><i>Institucioni në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përcakton procedurat e testimit dhe vlerësimit të njohurive të fituara nga studentët për çdo lëndë, duke garantuar zbatimin e tyre si dhe aftësimin e studentëve në përputhje me objektivat e programit të studimit.</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<b>Standardi III.3</b>	
<b>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>GVJ ka shqyrtuar rregulloren e programit të studimit Ciklit të dytë Master i Shkencave “Inxhinieri Elektronike” dhe ka konstatuar se në rregulloren e tij është përcaktuar se si realizohet testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Evidentohet fakti që raportet ndërmjet testimit e vlerësimit të vazhduar dhe vlerësimit përfundimtar përcaktohen nga pedagogët në programin e lëndës dhe miratohen nga Drejtuesi i Departamentit të Inxhinierive. Format kryesore të kontrollit të vazhduar janë detyrat/projektet e kursit, kolokiumet, aktivizimi në seminare dhe relacionet e punëve laboratorike dhe ato shërbejnë, ashtu si dhe provimi, për vlerësimin përfundimtar me notë.</p> <p><i>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023; RVB - MSc. IE - 10.2023. Tabela 15]</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Testimi dhe vlerësimi në “Albanian University” kryhet duke përdorur në mënyre të kombinuar metodat tradicionale me ato bashkëkohore si ato elektronike të microsoftit.</p> <p>Kontrolli i dijes bëhet me gojë, me shkrim, me detyra kursi, me projekte kursi. Në platformën Office 365 personeli akademik i këtij programi studimi përdor forma të ndryshme kontrolli si quize dhe assignments.</p> <p><i>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit dhe personelin akademik].</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>GVJ vlerëson se vlerësimi në provimin përfundimtar është 60 pikë sipas përcaktimeve në rregulloren e programit të studimit dhe syllabuseve të lëndëve, forma e tij përgjithësisht është me shkrim.</p> <p><i>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023]</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i provimeve përfundimtare të lëndëve shoqërohet me komente nga pedagogu, nëpërmjet këtyre komenteve qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin dhe cilësinë e punimeve të tyre ore rezultatet e testimeve. Edhe në takimin me studentët u konfirmua se procedura e kontrollit të dijeve dhe dhënia e rezultateve bëhet kryesisht sipas rregullores së Departamentit të Inxhinierive dhe nga ana e studentëve nuk u evidentuan problematika që mund ta dëmtonin procesin.</p> <p><i>[Ev: 2.3 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021: Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit]</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Studentët që në fillim të procesit mësimor informohen për veprime të ndaluara si kopjimi e plagjiatura. Studenti i cili kryen veprime të ndaluara, përjashtohet nga provimi. Testet e ndërmjetme dhe ai final administrohen nga prania në auditor e dy pedagogëve, të cilët janë përgjegjës për moslejimin e kopjimit.</p> <p><i>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021: 3.5.a Procedurë Diploma Master i Shkencave – v.a. 2021 – 2022]</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet jo më vonë se 7 ditë nga data e zhvillimit të tyre. Rezultatet e kontrollit të dijeve merren pasi korrigjohen provimet me shkrim dhe merret parasysh edhe ecuria e studentit gjatë semestrit, sipas pikëve të përcaktuar në sylabuset (frekuentimi, pjesëmarrja në diskutime, performanca në kryerjen e detyrave etj.)</p> <p><i>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021]</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Çdo student ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë në provim sikurse përcaktohet edhe në rregulloren e programit të studimit. Komisioni i vlerësimit sqaron vlerësimin e bërë dhe në rast mosdakordësie studentit i lind e drejta e ankimimit duke e depozituar me shkrim pranë sekretarisë mesimore të programit të studimit përkatës, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve.</p> <p><i>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021 3.6 Format kerkese per rishikimin e tezes.]</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i</p>	<p>GVJ konstaton se në rregullore përcaktohet se ankimimi i studentit i dërgohet Dekanit të njësisë kryesore i cili ngre një komision <i>ad-hoc</i> për rivlerësimin. Procesi i rivlerësimin të provimit kryhet brenda një</p>

posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	jave nga dita e depozitimit të ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore.  [Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021]			
<b>Konkluzione</b>	<i>Departamenti i Inxhinierive ka të përcaktuar në rregulloren e programit të studimit procedura të qarta dhe transparente të vlerësimit të njohurive të studentëve të bazuara në meritë e tij. Studenti ka mundësi të ankimohej për vlerësimin e marrë gjatë procesit mësimor, duke ngritur komisione ad hoc për shqyrtimin e ankimimit.  Institucioni kujdeset në zhvillimin e aktiviteteve vlerësuese të dijeve me korrektesë, duke mos pranuar kopjen dhe plagjiaturën nga ana e studentëve</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Mbështetur në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike”, GVJ konstaton se synohet formimi i ekspertëve dhe specialistëve në nivel cilësor në fushën e inxhinierisë elektronike dhe telekomunikacionit. Veprimtaritë formuese zhvillohen prej 12 lëndëve, ku dy kategoritë kryesore lëndët karakterizuese: 65 ECTS / 54,1% dhe lëndë ndërdisiplinore: 15 ECTS / 12,5% garantojnë aftësitë profesionale dhe shkencore të studentëve.  Pra, zhvillimi i programit të studimit sipas VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, mundëson marrjen e njohurive në mënyrë të balancuar dhe që lejon aftësimin profesional të studentit.  [Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021 RVB - MSc. IE - 10.2023. Tabela 8]
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	Programi i studimit Master i Shkencave “Inxhinieri Elektronike” zhvillon aftësi të veçanta në fushën e inxhinierisë elektronike përmes lëndëve karakterizuese 65 ETCS “Teoria e rrjetave të avancuara”, “Sensorët dhe Instrumentim procesesh” sipas

<p>informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>drejtimeve që ka programi i studimit. Programi i studimit siguron zhvillimin e aftësive bazike në fushat e teknologjisë së informacionit, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, sepse në kurrikulën e tij janë përfshirë lëndë të tilla si “Algoritëm dhe programim i avancuar”. Syllabuset e programit të studimit garantojnë përveç zhvillimit të aftësive e kompetencave në fushën elektronike edhe të komunikimit në gjuhë të huaj.</p> <p><i>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021 RVB - MSc. IE - 10.2023.pdf. Tabela 9; 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Në përfundim të vitit akademik pedagogët titullarë të lëndëve analizojnë kompetencat dhe aftësitë e përfituara nga studenti. Stafi akademik harton raportin semestral, në të cilin raporton për realizimin e objektivave të mësimdhënies. Departamenti i Inxhinierive analizon kompetencat profesionale të fituara nga studentët dhe i paraqet ato në analizën vjetore të tij në programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike”.</p> <p><i>[Ev: 3.7.b Shembull raporti semestral PAK - MSc. IE.; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet</p>	<p>GVJ vlerëson se personeli akademik transmeton dijet e tyre tek studentët duke demonstruar njohuritë dhe duke kryer punë laboratorike. Gjate zhvillimit të orëve mesimore, studentët realizojnë prezantime apo detyra kursi dhe projekte të ndryshme në fushën e inxhinierisë elektronike dhe telekomunikacionit. Sipas RVB dhe në bazë të vizitës së GVJ në institucion, personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instruktin studentët në kryerjen e detyrave pjesë të programit mësimor në lëndë të ndryshme. Detyra e kursit në lëndët përkatëse është një mundësi reale për zhvillimin e punës në grup.</p> <p><i>[Ev: 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 2.1.a Kurrikula MSc. IE – 04.2021; 3.8.d Axhenda - Konferenca e IV - IIST - 2022; 3.9.b Programi Forumi II Studentor “Transformimi digjital në kohën e sfidave” - 17.05.2022]</i></p>

ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.									
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Personeli akademik i programit të studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” është angazhuar edhe në veprimtari të tjera si konferenca apo seminare të ndryshme, ku kanë prezantuar në auditore të zgjeruara si leksione të hapura.</p> <p><i>[Ev: 1.1.d Raporti Sem. I - DI - v.a. 2021 – 2022; Vizita në Institucion, takimi me personelin akademik të programit]</i></p>								
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	<p>Departamenti i Inxhinierive që prej vitit 2019 dhe në vijimësi ka organizuar konferencën IIST ku studentët me pjesmarjen e tyre zhvillojnë idetë e tyre të reja. Ata gjithashtu në bashkëpunim dhe nën udhëheqjen e të stafit akademik të njësisë bazë zhvillojnë edhe aftësitë shkencore nëpërmjet pjesmarjes në këtë konferencë.</p> <p><i>[Ev. 3.8.d Axhenda - Konferenca e IV - IIST – 2019-2022]</i></p>								
<b>Konkluzione</b>	<p><i>Programi i studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” garanton rritjen e aftësive krijuese të studentëve nëpërmjet kurikulës së saj. Syllabuset e programit të studimit garantojnë përveç zhvillimit të aftësive e kompetencave në fushën elektronike edhe të komunikimit në gjuhë të huaj.</i></p> <p><i>Personeli akademik është angazhuar edhe në veprimtari të tjera si konferenca apo seminare të ndryshme në bashkëpunim edhe me studentët e programit të studimit duke ndihmuar në zhvillimin e kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</i></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet	Departamenti i Inxhinierive pranë Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në “Albanian University” ka hartuar një rregullore diplomimi, e cila jep në mënyrë të detajuar çdo procedurë
--	---

<p>përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>që ndiqet për temën e diplomës që nga shpallja e temave, caktimi i udhëheqësve, realizimi i temës dhe mbrojtja e saj. Studentët njihen paraprakisht me këto rregulla nëpërmjet procedurës së diplomimit në Master i Shkencave. Përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit është përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; 3.5.a Procedurë Diploma Master i Shkencave – v.a. 2021 – 2022]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive angazhon stafin akademik të orientojnë studentët në procesin e përmbylljes së studimeve. Kjo bëhet duke dhënë informacion në lidhje me mënyrën dhe rregullat e përgatitjes së temës së diplomës. Ai jep udhëzime dhe ndihmon në zgjedhjen e literaturës shtesë. Studentët aktualë të programit master deklaruan se po asistoheshin nga udhëheqësit e temës.</p> <p><i>[Ev: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; 3.5.a Procedurë Diploma Master i Shkencave – v.a. 2021 – 2022]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” testimi final bëhet nëpërmjet punimit të diplomës dhe mbrohet përpara një komisioni të posaçëm.</p> <p><i>[Ev: 3.5.a Procedurë Diploma Master i Shkencave – v.a. 2021 – 2022]</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i</p>	<p>Nga vizita në AU në takimin me studentët dhe me stafin akademik të këtij programi studimi, të dy palët konfirmuan se studentët ndihmohen përmes orientimeve të vazhdueshme, informacioneve e literaturës në procesin e përmbylljes së studimeve. <i>Rregullorja mesimore</i> përcakton se është udhëheqësi i diplomës që drejton, këshillon e konsulton. Pranë departamentit afishohet grafiku i kontrollit të vazhdimësisë së realizimit të temës së diplomës. Studentët deklaruan se ishin orientuar për temat dhe këtë grafik.</p> <p><i>[Ev: 3.5.a Procedurë Diploma Master i Shkencave – v.a. 2021 – 2022; H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021]</i></p>

plotë për t'u paraqitur para komisionit.	
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Institucioni vë në dispozicion ambientet e tij (laboratorët) ose lehtëson aksesin në ambientet e institucioneve bashkëpunuese në mbështetje të realizimit praktik të punimit të diplomës.
<b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Punimi i diplomës vlerësohet me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit pas prezantimit përpara komisionit të punimit të temës së diplomës.  <i>[Ev: 3.5.a Procedurë Diploma Master i Shkencave – v.a. 2021 – 2022]</i>
<b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Bazuar në procedurën e diplomimit studenti pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj të miratuar nga Senati Akademik i “Albanian University”, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Në përfundim të studimeve, institucioni vendos në dispozicion të studentëve një kopje të plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar, sipas vitit akademik përkatës, në rastet kur ai e kërkon këtë gjë.  <i>[Ev: E.2 Diploma - MSc. IE; E.3 Lista e notave dhe suplement - MSc. IE.; Vizita në Institucion, takimi me studentët e programit]</i>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sipas RVB, AU mban një kopje të dokumentacionit të studentit për një periudhë të pacaktuar me qëllim pajisjen e studentëve me informacione nëse kërkohen.  <i>[Ev: 4.7 Rregullore e sekretarisë mësimore; Vizita në Institucion, takimi në sekretarinë mësimore]</i>
<b>Konkluzione</b>	<i>Në programin e studimit Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” testimi final bëhet nëpërmjet punimit të diplomës dhe mbrohet përpara një komisioni të posaçëm. Në programin e studimit përcaktohet procedura e plotë për përgatitjes dhe mbrojtjes së temës së diplomës. Në përfundim studenti pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e saj. Studentit me kërkesë të tij i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit.</i>

Shkalla e përbushjes sëstandardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	NA
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	NA
<b>Kriteri 3.</b> Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	NA
<b>Konkluzione</b>	<i>Ky është një programi studimi Master i Shkencave “Inxhinieri Elektronike”</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1							
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.							
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve						
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Sipas përcaktimeve ligjore, personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Stafi akademik për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" sipas titujve dhe gradave, për tre vitet e fundit, paraqitet si vijon:						
	Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
		PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
	Prof. Dr	-	-	-	-	-	1
	Prof. Asoc.	-	1	2	1	2	0
	Dr/Phd	4	2	3	1	3	2
	Msc.	2	-	-	-	-	-
<b>Gjithsej</b>	<b>6</b>	<b>3</b>	<b>5</b>	<b>2</b>	<b>5</b>	<b>3</b>	
GVJ konstaton se, me përjashtim të vitit akademik 2020-2021, plotësohen kriteret ligjore për stafin akademik të angazhuar në këtë program. Gjithashtu, referuar CV të përfshira në DVV, GVJ konstatoi se ky personel ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik							

	<p>për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor. Gjithashtu, fusha kërkimore është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve.</p> <p>[Ev: Tabela Aneks RVB - MSc. IE; 4.2 CV stafi akademik MSc. IE - v.a 2022 - 2023]</p>																				
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit të DVV dhe atij plotësues të siguruar gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se mbulimi i ngarkesës për pesë vitet e fundit paraqitet si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="592 656 1358 1066"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti Akademik</th> <th colspan="2">Ngarkesa mësimore në % e realizuar nga:</th> </tr> <tr> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>76.0</td> <td>24.0</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>76.0</td> <td>24.0</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>69.3</td> <td>30.7</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>76.0</td> <td>24.0</td> </tr> <tr> <td>2022 - 2023</td> <td>69.6</td> <td>30.4</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në këtë mënyrë, mbulimi i ngarkesës mësimore nga personeli akademik efektiv (në raport me personelin akademik me kontratë) për programin e studimit përgjithësisht është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, por ka vite kur situata është pranë cënimit të kësaj kërkese.</p> <p>Megjithatë, duke referuar ngarkesës mësimore totale të realizuar për një vit akademik, vërehet se ka një mbingarkesë të theksuar të personelit akademik efektiv. Kjo mbingarkesë tejkalon dhe shtesën maksimale të orëve suplementare prej 200 orësh. Konstatohet se ka raste (2 raste) kur tejkalohet edhe shtesa prej 100 orësh të tjera që mund të akordohen në raste specifike, referuar Udhëzimit Nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë" dhe Udhëzimit Nr. 36, datë 23.11.2018 "Disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë".</p> <p>GVJ është i mendimit se në këtë situatë (të mbingarkesës së theksuar) ndikon edhe mënyra e pagesës së PAE. Nga takimi në institucion GVJ u informua se PAE paguhet me një pagesë bazë</p>	Viti Akademik	Ngarkesa mësimore në % e realizuar nga:		PAE	PAK	2018-2019	76.0	24.0	2019-2020	76.0	24.0	2020-2021	69.3	30.7	2021-2022	76.0	24.0	2022 - 2023	69.6	30.4
Viti Akademik	Ngarkesa mësimore në % e realizuar nga:																				
	PAE	PAK																			
2018-2019	76.0	24.0																			
2019-2020	76.0	24.0																			
2020-2021	69.3	30.7																			
2021-2022	76.0	24.0																			
2022 - 2023	69.6	30.4																			

	<p>(relativisht më të ulët) dhe se kësaj i shtohen orët e ngarkesës mësimore të realizuar. Në këtë mënyrë GVJ arrin në konkluzionin se nga PAE synohet realizimi i një ngarkese mësimore sa më të lartë. Referuar tabelës përmbledhëse me të ardhurat dhe shpenzimet për Departamentin e Inxhinierive, për programin financiar afat-mesëm 2022-2024 (treguesit e parashikuar) rezulton se fondi për paga-bazë përbën vetëm rreth 25% fondit total të pagave.</p> <p>[Ev.: Tabela Aneks RVB - MSc. IE: Te dhena me të ardhurat dhe shpenzimet për departamentin e Inxhinierive;</p> <p>4.1.a Ngarkesa mësimore stafi akademik MSc. IE - v.a. 2018 – 2019;</p> <p>4.1.b Ngarkesa mësimore stafi akademik MSc. IE - v.a. 2019 – 2020;</p> <p>4.1.c Ngarkesa mësimore stafi akademik MSc. IE - v.a. 2020 – 2021;</p> <p>4.1.d Ngarkesa mësimore stafi akademik MSc. IE - v.a. 2021 – 2022;</p> <p>4.1.e Ngarkesa mësimore stafi akademik MSc. IE - v.a. 2022 – 2023]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Referuar tabelave përmbledhëse në DVV si dhe nga verifikimet gjatë vizitës në institucion rezulton se përgjithësisht ka patur qëndrueshmëri të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Nga takimet me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ u informua se personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në programin e studimit ka lidhur kontratë pune me afat të pacaktuar për kategoritë Lektor dhe Profesor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. AU garanton dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik të punësuar. Personeli akademik me kontratë angazhohet mbi bazën e kontratave vjetore duke patur avantazh PAK i angazhuar edhe më parë.</p> <p>Nga takimet në institucion, GVJ u informua se AU ka mbështetur aplikimet nga ana e PAE për fitimin e gradave shkencore dhe titujve akademikë, brenda dhe jashtë vendit, duke patur gjatë viteve të fundit rezultate pozitive në këtë drejtim (1 pedagoge efektive ka marrë titullin akademik Prof. Asoc., 1 pedagoge ka marrë gradën shkencore Dr., ndërsa 1 PAE falë bashkëpunimeve të Departamentit ka vazhduar studimet e Doktoratës në Itali).</p> <p>[Ev.: Takime në institucion;</p>



	<p><i>RVB;</i>  <i>Takim me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore:</i>  <i>Tabela Aneks RVB - MSc. IE]</i></p>
<p><b>Kriteri 4. Institucioni</b> ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Rekrutimi i personelit akademik kryhet nëpërmjet procedurave të përcaktuara në Statutin e AU dhe në aktet e tjera rregullatore të institucionit. Në Statut përcaktohet se kriteret e konkurimit, propozohen nga njësitë përkatëse bazë dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit dhe nga Rektori i AU. Në funksion të mirëfunksionimit të procesit mësimor, njësitë bazë - Departamentet e AU kanë të drejtë të kërkojnë të punësojnë me kontratë për periudha të shkurtra kohe studiuës dhe/ose personalitete vendase ose të huaj, në fushat respektive të studimit në AU. Përzgjedhja e personelit akademik të ftuar duhet të kombinojë nevojën e njësisë për mësimdhënie ose kërkim shkencor me kualifikimet e tyre.</p> <p>Në Rregulloren e AU përcaktohet se në fillim të çdo viti akademik, bazuar në nevojat e tyre për personel akademik, njësitë bazë të Fakultetit përkatës i paraqesin Dekanatit të Fakultetit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante. Këto kërkesa i përcillen Rektoratit i cili zyrtarizon kriteret e pranimit dhe procedurat e konkurrimit. Universiteti ka të drejtën për të vendosur kritere të veçanta sipas pozicionit dhe përshkrimit të punës. Shqyrtimi i kandidaturave bëhet nga një Komision Vlerësimi, i cili propozon Dekanit për miratim kandidatët e përzgjedhur ku përparësi i jepet kandidatëve që plotësojnë më mirë kriteret dhe i përgjigjen përshkrimit të vendit të punës. Një element i veçantë i procedurës së rekrutimit ka të bëjë dhe me atë që kandidati i përzgjedhur i nënshtrohet një periudhe prove deri në 3 muaj në mbarim të së cilës përcaktohet nëse marrëdhënia e punës do të vazhdojë apo do të ndërpritet.</p> <p>Gjatë takimit në Zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ u njoh me procedurën e rekrutimit të personelit akademik dhe e gjeti procedurën e aplikuar në përputhje me aktet rregullatore të institucionit.</p> <p>[Ev.: 1.2 Statuti Albanian University;  1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022;  R.1.a Procedurë rekrutimi fillimi i vitit akademik 2021 – 2022;  R.1.b Procedure rekrutimi para fillimit të Sem. II - v.a. 2021 – 2022;  R.1.c Procedurë rekrutimi fillimi i vitit akademik 2022 – 2023;  R.1.d Procedurë rekrutimi para fillimit të semestrit të dytë – v.a. 2022 – 2023]</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni ka të angazhuar personel akademik ndihmës i cili ndjek dhe mbikëqyr mbarrëvajtjen dhe zhvillimin e punëve të laboratorit si dhe kontribon në mirëmbajtjen e laboratorëve. Nga shqyrtimi i CV të personelit ndihmës-akademik që kontribon në realizimin e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike", GVJ konstaton se kemi të bëjmë me personel ndihmës-akademik me kualifikim në fushën e Inxhinierisë Elektrike – Automatizim Industrie në nivelin Master i Shkencave. Në këtë mënyrë disponohet niveli i duhur për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore.</p> <p>[Ev.: Vizita në institucion; RVB]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Albanian University ka në strukturën e tij Zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila është përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ. Baza e të dhënave e disponuar përditësohet vazhdimisht për çdo ndryshim të numrit total të anëtarëve të personelit të angazhuar në program dhe mbulimit të ngarkesës së programit.</p> <p>Institucioni ruan jo vetëm informacionet lidhur me stafin akademik dhe personelin ndihmës-akademik, por edhe ngarkesën përkatëse për çdo semestër të vitit akademik.</p> <p>GVJ u informua se të dhënat menaxhohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>[Ev.: <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/struktura-institucionale/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/struktura-institucionale/</a> ; Takim me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore; RVB]</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV rezulton se AU ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me përfaqësues biznesi e institucione të sektorit publik. Praktika profesionale është pjesë e planit mësimor të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" e programuar me 12 kredite ECTS dhe zhvillohet në vitin e dytë (semestri i dytë). GVJ u informua se në funksion të praktikës profesionale, departamenti cakton për çdo student udhëheqësin akademik nga PAE, i cili mbikëqyr studentin përgjatë gjithë procesit. Në syllabusin e praktikës profesionale përcaktohet se studentët do të trajnohen pranë ndërmarrjeve dhe enteve publike apo private me të cilat universiteti bashkëpunon.</p>

<p>profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ është i mendimit se programimi i praktikës mësimore dhe zhvillimi i saj përbëjnë një element shumë pozitiv që kontribon në realizimin e suksesshëm të formimit në këtë diplomë. Elementë të tjerë mbi praktikën profesionale jepen edhe në syllabusin përkatës.</p> <p>[Ev.: 2.2 Miratim udhëheqës praktika mësimore MSc. - v.a. 2021 – 2022; 1.7.a Raporti analitik marrëveshje praktika – 2021; 1.7.b Raport analitik marrëveshjet praktika mësimore Departamenti i Inxhinierive - v.a. 2021 – 2022; Tabela Aneks RVB - MSc. IE; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023]</p>
<p><b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në rregulloren e Departamentit përcaktohet se koordinatori i programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe për zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> <p>Në kuadër të marrëveshjeve për praktikën mësimore, parashikohet përcaktimi nga ana e institucionit pritës i një udhëheqësi të praktikës, i cili kontrollon dhe informon mbi mbarëvajtjen e saj. Nga takimet në institucion GVJ u informua se një pjesë e studentëve të programit të studimit janë të punësuar dhe se praktikën e zhvillojnë në institucionet ku janë të punësuar.</p> <p>[Ev.: Tabela Aneks RVB - MSc. IE; Takime në institucion; 1.7.b Raport analitik marrëveshjet praktika mësimore Departamenti i Inxhinierive - v.a. 2021 – 2022; 2.3 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021]</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor si dhe fusha kërkimore është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve ;</li> <li>- Ngarkesa mësimore realizohet kryesisht nga personeli akademik efektiv duke respektuar përgjithësisht detyrimet ligjore e nënligjore në fuqi;</li> <li>- Vërehet se në një numër rastesh ka një mbingarkesë të theksuar të personelit akademik efektiv;</li> <li>- Rekrutimi i personelit akademik kryhet nëpërmjet procedurave të mirë përcaktuara dhe të pasqyruara në aktet rregullatore të AU;</li> </ul>

	<p>– GVJ konstaton se praktika profesionale përbën një element të rëndësishëm të formimit në këtë diplomë dhe zhvillohet në kompani/institucione me të cilat institucioni ka nënshkruar marrëveshje;</p> <p>– Zhvillimi i praktikës mësimore asistohet nga personel i dedikuar në kompanitë/institucionet pritëse.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Aktiviteti mësimor për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" zhvillohet në godinën në Rrugën së Kavajës. Në këto ambiente përfshihen auditorët për mësimdhënie, laboratorët dhe biblioteka. Ndërtesa është e rikonstruktuar në të gjitha ambientet e saj, me salla leksionesh, seminaresh dhe laboratorë në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> <p>GVJ konstatoi se ambientet janë me kushte të mira, ndërsa laboratorët janë të kompletuar dhe të mirëmbajtur në funksion të zhvillimit cilësor të procesit mësimor. Referuar DVV, AU ofron mjedise për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse përkatësisht rreth 13.23 m<sup>2</sup> për student dhe 4.45 m<sup>2</sup> për stafin.</p> <p>Mbështetur në VENDIM Nr. 418, datë 10.5.2017 "PËR STANDARDET, KRITERET DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN, NDARJEN, BASHKIMIN OSE MBYLLJEN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË DHE TË DEGËVE TË TYRE", normativa e sipërfaqes së shfrytëzueshme, për fushat Inxhinieri dhe teknologji duhet të jetë 5m<sup>2</sup> për student.</p> <p>GVJ është i mendimit që institucioni e plotëson këtë kriter në aspektin formal, por kjo vjen nga një interpretim i diskutueshëm i Vendimit Nr.418. Në fakt institucioni, duke qenë se programet e studimit Master zhvillohen pasdite llogarit gjithë sipërfaqen në dispozicion të tyre.</p>

	<p>[Ev.: Tabela Aneks RVB - MSc. IE (Tabela 16); 1.1.e Raporti vjetor Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2021 – 2022; Vizita në ambientet e institucionit]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në ambientet e AU në Rugën e Kavajës, konstatoi se disponohen klasa, laboratorë e mjedise të tjera, të cilat janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Referuar DVV dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se personeli akademik disponon hapësira të mjaftueshme dhe të mirëpaisura për zhvillimin e aktivitetit të tij në shërbim të programit të studimit. Në ambientet e godinës ku zhvillohet procesi mësimor garantohej mundësia e aksesimit të internetit (lidhje wireless).</p> <p>[Ev.: Tabela Aneks RVB - MSc. IE (Tabela 16); 1.1.e Raporti vjetor Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2021 – 2022; Vizita në ambientet e institucionit]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive ka funksionalë laboratorët:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Laboratorët e Informatikës 1 – 2 (Simulimeve);</li> <li>- Laboratori i Infrastrukturës së Rrjetave;</li> <li>- Laboratori i Fizikës;</li> <li>- Laboratori i Kimisë;</li> <li>- Laboratori i Elektroteknikës;</li> <li>- Laboratori i elektronikës analoge\laboratori i elektronikës dixhitale;</li> <li>- Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronike;</li> <li>- Laboratori i automatikës dhe kontrollit (dhe Mekatronikës);</li> <li>- Laboratori i makinave elektrike;</li> <li>- Laboratori i instalimeve elektronike.</li> </ul> <p>Gjithashtu programet informatike të instaluar në laboratorët e Informatikës mbështesin plotësisht zhvillimin e lëndëve të programit mësimor.</p> <p>GVJ, gjatë vizitës së ambienteve, pati rastin të njihet me këtë infrastrukturë laboratorike dhe është i mendimit se i plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p>[Ev.: 1.5 Përshkrimi i Laboratoreve të Departamentit të Inxhinierive; Vizita në laboratorët e institucionit]</p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Për vetë natyrën e programit të studimit, mbështetja për realizimin e tij është, në një masë të konsiderueshme dhe laboratorët e informatikës, të cilët janë të pajisur me programe profesionale dhe mbështesin realizimin cilësor të procesit mësimor me gjithë elementët e tij përbërës. Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i paisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit ndihmës akademik me kualifikimin e duhur.</p> <p>[Ev.: 1.5 Përshkrimi i Laboratoreve të Departamentit të Inxhinierive; Vizita në institucion; RVB]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV rezulton se AU ka një sërë marrëveshesh bashkëpunimi me përfaqësues biznesi e institucione të sektorit publik.</p> <p>Në kuadër të marrëveshjeve për praktikat mësimore, parashikohet përcaktimi nga ana e institucionit pritës i një udhëheqësi të praktikës, i cili kontrollon dhe informon mbi mbarëvajtjen e saj.</p> <p>Nga takimet në institucion GVJ u informua se një pjesë e studentëve të programit të studimit janë të punësuar dhe se praktikën e zhvillojnë në institucionet ku janë të punësuar.</p> <p>[Ev.: Tabela Aneks RVB - MSc. IE; Takime në institucion; 1.7.b Raport analitik marrëveshjet praktika mësimore Departamenti i Inxhinierive - v.a. 2021 – 2022; 2.3 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021]</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>– Mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor janë me kushte shumë të mira, ndërsa laboratorët janë të kompletuar dhe të mirëmbajtur në funksion të zhvillimit cilësor të procesit mësimor;</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Institucioni plotëson kushtin e sipërfaqes së shfrytëzueshme për student që i korrespondon fushës Inxhinieri dhe teknologji (duke konsideruar vetëm studentët e ciklit Master);</li> <li>- Infrastruktura informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</li> <li>- Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i paisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit ndihmës akademik me kualifikimin e duhur.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi IV.3</b>	
<b>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Nga takimet me personelin akademik dhe studentët, GVJ u informua se literatura bazë është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, ndërsa literatura plotësuese është përgjithësisht në gjuhë të huaj (kryesisht anglisht). Gjithashtu studentëve u vihen në dispozicion nga ana e pedagogëve edhe leksionet (të shkruara ose prezantime Powerpoint), të cilat përmbajnë një informacion më të përditësuar.</p> <p>[Ev.: Takim me studentët dhe pedagogët;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/bibloteka/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/bibloteka/</a>  Vizitë në Bibliotekë]</p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	<p>Nga takimet në institucion, GVJ u informua se personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, në mënyrë të vazhdueshme pasqyron në ciklet e leksioneve dhe seancave praktike të rejat që lidhen me lëndët përkatëse. Gjithashtu biblioteka procedon në mënyrë të vazhdueshme me blerje tekstesh të reja, blerje e cila bëhet mbi bazën e kërkesave të departamenteve.</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve, GVJ konstatoi në përgjithësi në to janë pasqyruar përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>

	[Ev.: 2.8 Kërkesë pasurimi i bibliotekës v.a. 2021 – 2022; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023]
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Departamenti i Inxhinierive, në godinën në Rrugën e Kavajës, disponon një ambient të dedikuar për bibliotekën mësimore. Ky ambient i bibliotekës ofron hapësira për lexim dhe studim nga ana e studentëve. Në bibliotekë janë të instaluar 25 terminale të lidhura në një kompjuter qendror, të cilët vihen në dispozicion të studentëve. Biblioteka ka një sipërfaqe prej rreth 63m <sup>2</sup> dhe është në dispozicion të studentëve të programit të studimit duke ofruar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë prej tyre.  [Ev.: 4.5 Planimetrite - Godina e Rr. Kavajes – 2020; 4.6 Lista e librave në bibliotekë – 2022; Vizita në bibliotekë]
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka disponon rreth 120 tituj librash në fushat inxhinierike me 398 kopje, nga të cilat 80% janë pjesë e literaturës së detyruar në gjuhën shqipe, e paraqitur në syllabuset e lëndëve. Në bibliotekë gjendet mbi 80% e literaturës së detyruar në gjuhën shqipe. Literatura e ofruar kontribon në realizimin me sukses të projekteve kërkimore shkencore të kërkuara nga pedagogët në kuadër të mësimdhënies dhe në përgatitjen e tezës së diplomës. Gjithashtu, për të patur në mënyrë të vazhdueshme një informacion më të përditësuar, studentëve u vihen në dispozicion nga ana e pedagogëve edhe leksionet (të shkruara ose prezantime Powerpoint).  [Ev.: 4.6 Lista e librave në bibliotekë – 2022; RVB; Vizita në bibliotekë]
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve një sërë librarish online, të cilat janë të aksesueshme pa pagesë për të gjithë studentët e interesuar nën kujdesin e punonjësës së bibliotekës në qendrën e internetit. Në portalin <a href="http://www.portal.getty.edu">www.portal.getty.edu</a> ofrohen rreth 100.000 volume librash të vëna në dispozicion nga një sërë universitetesh në mbarë botën. Ndërsa në bibliotekën on line <a href="http://www.elsevier.com">www.elsevier.com</a> ofrohen për studentët 46 907 tituj librash dhe 2221 gazeta.  [Ev.: Tabela Aneks RVB - MSc. IE (Tabela 17); <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/bibloteka-online/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/bibloteka-online/</a> ; Vizita në bibliotekë]

<p><b>Kriteri 6. Biblioteka</b> duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Në bibliotekë janë të instaluar 25 terminale të lidhura në një kompjuter qëndror, të cilët vihen në dispozicion të studentëve. Kompjuterat e bibliotekës kanë qasje në internet dhe mundësi të përdorimit të bibliotekave online nga studentët dhe pedagogët. Eventualisht përdorimi i librarive online mund të sigurohet edhe nëpërmjet kompjuterave personalë (laptop) me mundësi aksesit të ofruar nga institucioni.</p> <p>[Ev.: <i>Tabela Aneks RVB - MSc. IE (Tabela 17)</i>; <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/biblioteka/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/biblioteka/</a> ; <i>Vizita në bibliotekë</i>]</p>						
<p><b>Kriteri 7. Biblioteka</b> duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ u informua se se studentët e programit të studimit kanë mundësinë të shfrytëzojnë bibliotekën fizike nga dita e hënë deri ditën e premte në orën 08.00 – 16.00 si dhe ditën e shtunë ora 08.00 – 12.00. GVJ u informua gjithashtu se për studentët e programeve të studimit Master, biblioteka vihet në dispozicion edhe gjatë orareve të pasdites 16:00 20:00 nga sekretaria mësimore, e cila asiston këto programe studimi në përshtatje me orarin e zhvillimit të procesit mësimor. Në veçanti oraret e pasdites janë të mjaftueshëm për një shfrytëzim optimal të mundësive që ofron biblioteka dhe mbulojnë oraret e zhvillimit të procesit mësimor të ciklit Master. Studentët regjistrohen në kartelat që iu lejon të marrin librat në ambientet e sallave të studimit brenda universitetit.</p> <p>[Ev.: <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/biblioteka/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/biblioteka/</a> ; <i>Vizita në bibliotekë</i>]</p>						
<p><b>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke</b></p>	<p>GVJ konstaton përpjekje të institucionit dhe Departamentit të Inxhinierive në veçanti për pasurimin e bibliotekës dhe plotësimin e kërkesave të stafit akademik me libra. Është synuar që literatura bazë të jetë e disponueshme në fondin fizik, por vëmendje e veçantë i është kushtuar dhe aksesit në bibliotekat online duke zgjeruar në këtë mënyrë aksesin e studentëve dhe personelitë akademik në një literatura të përditësuar. Gjithashtu biblioteka procedon në mënyrë të vazhdueshme me blerje tekstesh të reja:</p> <table border="1" data-bbox="539 1709 1118 1921"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Hyrja e teksteve të reja</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018 - 2019</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>2019 -2020</td> <td>48</td> </tr> </tbody> </table>	Viti	Hyrja e teksteve të reja	2018 - 2019	1	2019 -2020	48
Viti	Hyrja e teksteve të reja						
2018 - 2019	1						
2019 -2020	48						

nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	2021 - 2022		22	
	Blerja e teksteve të reja bëhet mbi bazën e kërkesave të departamenteve. [Ev.: RVB; 1.1.a Raporti Vjetor - DI - v.a. 2018 - 2019; 1.1.b Raporti vjetor - DI - v.a. 2019 – 2020; 1.1.e Raporti vjetor Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2021 – 2022]			
<b>Konkluzione</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Literatura bazë është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, ndërsa literatura plotësuese është përgjithësisht në gjuhë të huaj;</li> <li>- Biblioteka vihet në dispozicion të studentëve të programit të studimit edhe pasdite në orare të cilat përputhen me ato të zhvillimit të procesit mësimor;</li> <li>- Ka përpjekje për pasurimin e bibliotekës dhe plotësimin e kërkesave të stafit akademik me libra. Është synuar që literatura bazë të jetë e disponueshme në fondin fizik;</li> <li>- Vëmendje e veçantë i është kushtuar aksesit në bibliotekat online duke zgjeruar në këtë mënyrë aksesin e studentëve dhe personelit akademik në një literaturë të përditësuar.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore. Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se dokumentacioni që disponohet është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Përsa i përket menaxhimit të informatizuar të informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre, kjo sigurohet nëpërmjet sistemit <i>Pitagora</i> . Çdo student ka llogarinë e tij, ku mund të logohet me kredencialet personale dhe të marrë informacionin personal në lidhje me të dhënat e tij të

	<p>përditësuara, rezultatet e arritura, lëndët të cilat duhet të frekuentojë etj.</p> <p>[Ev.: <i>Vizitë në Sekretarinë Mësimore;</i> 4.7 <i>Rregullore e sekretarisë mesimore;</i> <a href="https://au.pitagora.rash.al/">https://au.pitagora.rash.al/</a> ]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi <i>Pitagora</i> i zhvilluar nga RASH ofron funksionalitete për administratën e sekretarisë të universitetit dhe përdoruesit fundor (studentëve, pedagogëve, etj) për menaxhimin e të gjithë ciklit akademik të studimeve universitare: si regjistrimi në syllabuset e kurseve, vlerësimet, procesverbalet e provimeve, diplomimi, transferimet ndërmjet universiteteve dhe mbartja e krediteve të fituara, etj. Megjithatë, GVJ është i mendimit se akoma nuk kemi të bëjmë me një sistem informacioni tërësor për të menaxhuar plotësisht informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>[Ev.: <i>RVB;</i> <i>Vizita në institucion;</i> <a href="https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/">https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/</a> ]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët përmes sekretarisë <i>online</i> (sistemi <i>Pitagora</i>) mund të aksesojnë në kohë reale të dhënat e tyre të përditësuara, rezultatet e arritura, lëndët, të cilat duhet të frekuentojnë etj. Aksesin në sistemin <i>Pitagora</i> mundësohet nëpërmjet faqes web, ku propozohet hyrja dedikuar nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar.</p> <p>[Ev.: <i>RVB;</i> <i>Vizita në institucion;</i> <a href="https://au.pitagora.rash.al/">https://au.pitagora.rash.al/</a> ]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë formë të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga GVJ u konstatua që midis studentëve dhe personelit akademik ekziston një komunikim interaktiv, si fizik, student-staf akademik gjatë orës së mësimi, ashtu edhe jashtë saj. Stafit akademik, ai administrativ dhe studentët disponojnë <i>email</i>-et zyrtare të Institucionit, bashkë me të cilët ofrohet paketa <i>Office 365</i>, aplikacionet e të cilës mundësojnë ruajtjen dhe shpërndarjen e informacionit, si dhe komunikimin interaktiv në kohë reale ndërmjet përdoruesve.</p> <p>Informacione të detajuara për aktivitete të ndryshme, kuadrin ligjor, kërkimin shkencor, transparencën, shërbime që ofrohen etj. jepen dhe në faqen web të institucionit.</p> <p>[Ev.: <i>Takime në institucion;</i></p>

	<p>3.2 Klasat Microsoft Teams - Departamenti i Inxhinierive;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/">https://albanianuniversity.edu.al/</a> ;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/universiteti/akte-normative/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/universiteti/akte-normative/</a>  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/sherbime/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/category/sherbime/</a> ]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Sistemi <i>Pitagora</i> mundëson hyrje të dedikuar nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar. Gjithashtu, në dispozicion janë dhe aplikacionet e paketës <i>Office 365</i> dhe faqja zyrtare e AU ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë.</p> <p>Sistemi <i>Pitagora</i> është në gjendje në mënyrë të automatizuar të përpunojë informacionin dhe të krijojë raporte përmbledhëse: mbi kalueshmërinë, apo vlerësimin e studentëve.</p> <p>[Ev.: <i>Vizitë në sekretarinë mësimore</i>;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/">https://albanianuniversity.edu.al/</a> ;  <a href="https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/">https://www.rash.al/sq/software/universitare/pitagora/</a> ;  <a href="https://au.pitagora.rash.al/">https://au.pitagora.rash.al/</a> ]</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Të dhënat për programin e studimit Master i Shkencave në "<i>Inxhinieri Elektronike</i>" publikohen në faqen zyrtare të AU në seksionin e dedikuar për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe Departamentin e Inxhinierive. Në këtë faqe gjendet informacioni i përditësuar edhe për personelin akademik dhe aktivitete të ndryshme. Informacioni në faqen web ofrohet në tre gjuhë: shqip, anglisht dhe pjesërisht në italisht.</p> <p>[Ev.: <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/</a>;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/departamenti-i-inxhinierive/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/departamenti-i-inxhinierive/</a> ;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-staf/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-staf/</a>]</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin mbahet nga Sekretaria Mësimore dhe menaxhohet elektronikisht nëpërmjet sistemit Pitagora;</i></li> <li>- <i>Studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore u mundësohet hyrje e dedikuar nëpërmjet emrit të përdoruesit dhe fjalëkalimit të personalizuar;</i></li> <li>- <i>Informacionet për programin Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" publikohen në tre gjuhë në faqen zyrtare të AU.</i></li> </ul>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Nga takimet në institucion GVJ u informua se Albanian University harton një raport të përvitshëm financiar në nivel institucioni, të cilin e çertifikon edhe me auditues të jashtëm. Në këtë raport paraqiten të ardhurat dhe shpenzimet që institucioni kryen. Duhet theksuar se, referuar tabelës 18 në RVB, ka një rënie të të ardhurave nga tarifat për dhe gjatë shkollimit në rang institucioni. Kjo rënie nga viti akademik 2018-2019 në vitin akademik 2022-2023 është rreth 24%. Në se kjo tendencë rënieje vazhdon, kjo mund të ndikojë në gjendjen financiare të institucionit në përgjithësi dhe eventualisht edhe te programi i studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike".</p> <p>Megjithatë, në stadin aktual, GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. <i>Megjithatë kjo problematikë (që lidhet kryesisht me rënien e numrit të studentëve në rang institucioni) duhet mbajtur në konsideratë në vitet në vijim.</i></p> <p>[Ev.: Takime në institucion; RVB; Tabela Aneks RVB - MSc. IE (Tabela 18)]</p>




<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>AU, si pjesë e Shoqërisë UFO shpk., i akordohet një buxhet vjetor në përputhje me nevojat, bazuar në programin financiar afatmesëm tre vjeçar, ku është përcaktuar gjithashtu plani për mbarëvajtjen e programit të studimit.</p> <p>Procesi i hartimit të programi financiar fillon në muajin Shtator dhe miratohet në organet përkatëse brenda muajit Dhjetor të vitit paraardhës financiar.</p> <p>Para fillimit të vitit të ri akademik, Bordi i Administrimit vendos kriteret mbi të cilat do hartohet projektbuxheti vjetor dhe rregullat për mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave që siguron institucioni nga ushtrimi i veprimtarive të tij dhe ja përcjell organeve drejtuese akademike dhe administrative.</p> <p>Bazuar në këto kritere, Administratori i Përgjithshëm i AU, i cili është edhe anëtar i Rektoratit, në bashkëpunim me zyrën e financës dhe administratorët e njësive kryesore, mbështetur në nevojat e paraqitura nga njësitë bazë dhe kryesore, harton projektbuxhetin vjetor dhe atë afat mesëm tre vjeçar.</p> <p>Buxheti vjetor dhe ai afatmesëm tre vjeçar, pasi diskutohet në Rektorat, kalon në Senatin Akademik. Senati e miraton paraprakisht dhe ia përcjell për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.</p> <p>Në mënyrë të detajuar kontributi i burimeve të financimit për pesë vitet e fundit paraqitet si vijon:</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen</p>	<p>Në AU funksionon si njësi administrative, Zyra e Auditit të Brendshëm. Zyra e Auditit të Brendshëm, si pjesë integrale e kontrollit të brendshëm</p>

Të ardhurat	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022	2022-2023
	%	%	%	%	%
Pushteti qëndror/ vendor	0	0	0	0	0
Grantet për kërkim dhe kontratat	0	0.4	0.8	1.5	0
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	98.9	98.4	98.4	97.1	98.6
Sponsorizimet	0	0	0	0	0
Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)	0	0	0	0	0
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, rezidencat, etj.)	1.1	1.2	0.8	1.4	1.4

<p>auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>dhe njësi e specializuar e saj, ka për mision kontrollin e proceduarve dhe rregullave të vendosura në rregulloren e funksionimit të Zyrës së Financës dhe Auditit të Brendshëm.</p> <p>Referuar RVB, Institucioni kryen edhe audit të përvitshëm për situatën financiare nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik, raportet e të cilëve ndërtohen sipas standardeve përkatëse. Raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet. Raportet e auditit të brendshëm dhe të jashtëm analizojnë eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve dhe përdorimin e tyre për të bërë të mundur rritjen e cilësisë së studimeve për të gjitha ciklet. Ato raportohen në mënyrë periodike pranë Bordit të Administrimit.</p> <p>GVJ u njoh me një raport auditit të Audituesit të Pavaruar për vitin 2022, i cili konfirmonte paraqitjen drejt në të gjitha aspektet materiale Pozicionin Financiar të Shoqërisë në datën 31 dhjetor 2022, Performancën Financiare dhe Flukset e Parasë në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. <i>Megjithatë GVJ nuk pati mundësinë të njihet me Pasqyrat financiare të analizuar nga Audituesi i Pavarur.</i></p> <p>[Ev.: RVB; Raport auditit; Vizita në institucion]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Referuar RVB, Institucioni ka të dokumentuara raportet financiare për të tri vitet e fundit, procedurat e të cilave fillojnë të kryhen gjatë periudhës Mars-Maj. Rektorati përgatit raportin financiar të realizuar, mbështetur në planifikimet e kryera në programin financiar. Ky raport miratohet nga Bordi i Administrimit. Në përfundim të kësaj faze realizohet edhe një analizë që planifikon ndërhyrjet e nevojshme në të ardhmen për mbarëvajtjen e programeve të studimit.</p> <p>Referuar tabelës përmbledhëse me të ardhurat dhe shpenzimet për Departamentin e Inxhinierive, për programin financiar afatmesëm 2022-2024 (treguesit e parashikuar) rezulton se financimi i këtij programi studimi është i garantuar për një periudhë disa vjeçare.</p> <p>Megjithatë analizat e kryera në nivel njësie bazë dhe të pasqyruara në raportet semestrale dhe vjetore nuk japin elementë në këtë drejtim.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion; Te dhena me të ardhurat dhe shpenzimet për departamentin e Inxhinierive; RVB; 1.1.e Raporti vjetor Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2021 – 2022]</p>

<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Referuar RVB, situata financiare dhe bankare dëshmon se AU ka qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të këtij programi studimi dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësim të mëtejshëm dhe gjenerim të të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. Megjithatë duhet theksuar se në një masë të madhe (mbi 98%) burimi i financimit janë tarifatat për dhe gjatë shkollimit. GVJ është i mendimit se <b>AU duhet të shtojë më tej përpjekjet për rritjen e të ardhurave</b> nëpërmjet granteve të projekteve kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombtare si dhe prej shërbimevet trainuese (kualifikimit të vazhdueshëm).</p> <p>[Ev.: Takime në institucion; RVB; Tabela Aneks RVB - MSc. IE (Tabela 18)]</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- GVJ konstaton se deri më tani institucioni ka siguruar në vazhdimësi mbështetje financiare për mbarëvajtjen e programit të studimit, duke mundësuar rinovimin e laboratorëve, pasurimin e bibliotekës, mbështetjen e mobiliteteve, etj.</li> <li>- GVJ nuk gjeti elementë të analizës së buxhetit në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit;</li> <li>- Ka një rënie të të ardhurave nga tarifatat për dhe gjatë shkollimit në rang institucioni (deri në 24% për 5 vjet);</li> <li>- AU duhet të shtojë më tej përpjekjet për rritjen e të ardhurave nëpërmjet granteve të projekteve kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombtare si dhe prej shërbimevet trainuese;</li> <li>- GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</li> </ul>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Nga takimet në institucion dhe shqyrtimi i DVV, GVJ konstatoi se për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" pranimit i studentëve, përparimi i tyre përgjatë kursit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Në mënyrë të veçantë realizimi i këtyre elementëve mbështetet në Statutin e AU, Rregulloren e AU, Rregulloren e FSHAE, Rregulloren e Departamentit të Inxhinierive dhe Rregulloren e programit të studimit. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e FSHAE zhvillohet në përputhje me këto rregullore, të cilat janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi.</p> <p>[Ev.: 1.3 Rregullore Albanian University; 1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022; 2.3 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021; H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021]</p>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për	<p>Politikat dhe procedurat e ndjekura nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike janë të mirëpërcaktuara duke garantuar barazinë tek çdo student në këtë program studimi. GVJ konstatoi se garancia sigurohet nëpërmjet përcaktimit në rregulloret e ndryshme të të gjithë elementëve që lidhen që me pranimin në këtë program</p>

<p>studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>studimi, ndjekjen e procesit mësimor, vlerësimin e studentit e deri në diplomim. Procedurat e ndjekura janë në përputhje dhe përshtaten në mënyrë të vazhdueshme me udhëzimet, vendimet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Veprimtaria mësimore organizohet dhe realizohet nga Departamenti i Inxhinierive dhe drejtohet dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese përkatëse me kompetenca të përcaktuara në rregulloret përkatëse.</p> <p>[Ev.: 1.3 Rregullore Albanian University; 1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022; 2.3 Rregullore Departamenti - VS. 20 - 30.07.2021; H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Pranimi në programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" bazohet në ligjin nr.80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 76, "Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të dytë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit të arsimit të lartë ku ata aplikojnë. Kriteret e pranimit të kandidatëve në programet e ciklit të dytë të studimeve përcaktohen nga njësi bazë ofruese e programit."</p> <p>Nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstatoi se për këtë program studimi nuk ka të përcaktuar kriter për notën mesatare, por në fazën e shqyrtimit të kërkesave për të ndjekur programin e ciklit të dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike", në çdo rast, vlerësohen pozitivisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- programi i studimit të ciklit të parë që ka ndjekur studentit çon drejtpërsëdrejti në programin e studimit të ciklit të dytë ku studentit kërkon të regjistrohet. Në këto raste studentit i njihet e drejta për t'u regjistruar në programin e zgjedhur;</li> <li>- programi i studimit të ciklit të dytë që ka ndjekur studentit ka ngjashmëri jo më pak se 60% me programin bazë që çon drejtpërdrejt në ciklin e dytë. Në këto raste, për programe studimi të afërta të të njëjtit institucion apo programe të njëjta e të afërta të institucioneve të tjera të arsimit të lartë, të cilat konsiderohen të përputhshme e të pranueshme, studentit i njihet e drejta për t'u regjistruar në programin e zgjedhur.</li> </ul> <p>Për pesë vitet e fundit akademike rregjistrimet për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" kanë qenë si vijon:</p>

Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve	Totali
2018-2019	28	1 (viti 2)	29
2019-2020	31	-	31
2020-2021	17	-	17
2021-2022	22	-	22
2022-2023	20	-	20

Për studentët e huaj kusht suplementar është njohja e gjuhës shqipe si dhe njehsimi i diplomës së fituar nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë.

[Ev.: *H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021*;  
<https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimet-2/>;  
<https://albanianuniversity.edu.al/sq/dokumentacioni-i-kerkuar-per-aplikime-dhe-regjistrime-ne-albanian-university/> ;  
*Tabela Aneks RVB - MSc. IE*]

**Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. GVJ konstatoi se një ndihmesë të rëndësishme në procesin e informimit të kandidatëve për studentë dhe njohjes së kriterëve dhe procedurave japin faqja web e institucionit (kryesisht për pranimet, ofertën akademike, një tablo të përgjithshme të AU etj.) si dhe për një numër elementësh që lidhen me programin e studimit dhe Departamentin e Inxhinierive.

Në rregulloren e Rregjistrimeve dhe Transferimeve jepen informacione të detajuara për njohjen e plotë ose të pjesshme të studimeve të mëparshme. Të gjitha këto informacione vihen në dispozicion të studentëve nga strukturat përkatëse, të cilat janë të disponueshme edhe për sqarime të mëtejshme.

GVJ është i mendimit se kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.

[Ev.: <https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranimet-2/>;  
<https://albanianuniversity.edu.al/sq/dokumentacioni-i-kerkuar-per-aplikime-dhe-regjistrime-ne-albanian-university/> ;  
<https://albanianuniversity.edu.al/sq/departamenti-i-inxhinierive/> ;

	2.5 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve - VS 25 - dt. 25.06.2020]										
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	<p>Kërkesat e kriteret për këtë program studimi publikohen në faqen web përpara fillimit të vitit akademik. Gjithashtu, Departamenti i Inxhinierive, në fund të çdo viti akademik, organizon, me studentët diplomantë në programet e studimit <i>Master i Shkencave</i>, takime informuese mbi programet Master që ofron.</p> <p>Në këtë proces kontribuon dhe Guida e Universitetit e cila jep informacione të përgjithshme mbi AU dhe mundësitë që ofrohen për ndjekjen e studimeve.</p> <p>[Ev.: <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranim-it-2/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranim-it-2/</a>; <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/dita-informuese-mbi-programet-master-te-ofruara-nga-departamenti-i-inxhinierive/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/dita-informuese-mbi-programet-master-te-ofruara-nga-departamenti-i-inxhinierive/</a>; <a href="https://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2020/07/AU-University-GUIDA-2020-2021-.pdf">https://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2020/07/AU-University-GUIDA-2020-2021-.pdf</a>]</p>										
<b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	<p>GVJ u informua se AU, përpara fillimit të çdo viti akademik, miraton kriteret dhe kuotat, ku përfshihen edhe kategoritë e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave, kandidatëve nga trojet dhe shtresat e marginalizuara. Për vitin akademik 2022-2023 kuotat e miratuara paraqiten si vijon (për gjithë AU):</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>Statusi</th> <th>Kuotat</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Statusi i jetimit</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>Persona me aftësi ndryshe</td> <td>3</td> </tr> <tr> <td>Komuniteti rom dhe ballkano-egjiptian</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Kandidatë nga trojet</td> <td>69</td> </tr> </tbody> </table> <p>GVJ konstatoi se nuk ka kritere të veçanta, por përzgjedhja e kandidatëve fitues bëhet në përputhje me kriteret e përgjithshme të miratura nga AU.</p> <p>[Ev.: RVB; Takime në institucion]</p>	Statusi	Kuotat	Statusi i jetimit	7	Persona me aftësi ndryshe	3	Komuniteti rom dhe ballkano-egjiptian	1	Kandidatë nga trojet	69
Statusi	Kuotat										
Statusi i jetimit	7										
Persona me aftësi ndryshe	3										
Komuniteti rom dhe ballkano-egjiptian	1										
Kandidatë nga trojet	69										
<b>Kriteri 7.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	<p>Për kandidatët me origjinë shqiptare nga Republika e Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci kërkohet dhe kopje e dëftesës/diplomës dhe listes së notave të njehsuar nga QSHA. Për kandidatët e huaj, plus kopjes së dëftesës/diplomës dhe listes së notave të njehsuar nga QSHA, kërkohet dhe dëshmi e gjuhës shqipe.</p> <p>[Ev.: H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranim-it-2/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret-e-pranim-it-2/</a>;</p>										


	<p><a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/dokumentacioni-i-kerkuar-per-aplikime-dhe-regjistrime-ne-albanian-university/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/dokumentacioni-i-kerkuar-per-aplikime-dhe-regjistrime-ne-albanian-university/</a> ]</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ u informua se AU ndjek traditën e Programit të Ekselencës në vitet e ndërmjetme për studentët që kanë një mesatare të lartë në përfundim të çdo viti studimi, duke i motivuar ata për të vazhduar të kenë një performancë akoma më të mirë në të ardhmen. Të tilla programe i shërbejnë jo vetëm eksperiencës së universitetit, por edhe motivojnë studentët në studimin dhe kërkimin shkencor.</p> <p><u>Bursat e ndërmjetme:</u> Studentët, që në vitet e para të studimeve universitare arrijnë rezultate të larta përfitojnë 50% dhe 30% zbritje të pagesës vjetore për vitin e ardhshëm akademik. Gjithashtu këtyre studentëve u jepet mundësia, që të punojnë si asistentë të pedagogëve në praktikat mësimore për vitet e para.</p> <p><u>Bursa të tjera:</u> Disa bursa të tjera ofrohen nga “Albanian University”, sipas strategjisë së këtij universiteti, për jetimët dhe për studentët, që u takojnë kategorive të tjera sociale. “Albanian University” gjatë këtyre viteve në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme ka ofruar dhjetëra bursa për fëmijët e policëve të vrarë, për jetimët, për personat me aftësi të kufizuara, komunitetin rom etj.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion; RVB; <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/bursat/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/bursat/</a> ]</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Veprimtaria e FSHAE zhvillohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi.</i></li> <li>- <i>Ka një bashkëpunim të mirë ndërmjet hallkave të ndryshme konsultative dhe vendimarrëse në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me pranimin e studentëve.</i></li> <li>- <i>Kriteret dhe procedurat e pranimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej MAS. Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</i></li> <li>- <i>Në faqen web të AU publikohen kriteret për regjistrimin e kandidatëve të të gjithë kategorive (shtetas shqiptarë, atyre nga trojet shqiptare, shtetasve të huaj, kriteret për transferim studimesh etj.) .</i></li> <li>- <i>AU aplikon politikat specifike për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike..</i></li> </ul>



Shkalla e përmbushjes së standardit			Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ konstatoi se studentëve u vihet në dispozicion një informacion i gjerë në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, elementët detyrues të tij si dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. GVJ evidentoi që burimet bazë të informimit janë rregulloret e institucionit (Rregullorja e AU; Rregullorja e FSHAE) si dhe Rregullorja e programit të studimit. Institucioni, njeh studentët me përmbajtjen e programit të studimit dhe rregulloren përkatëse, me vëmendje të veçantë në procedurat e përparimit të tyre akademik dhe kalimit nga një vit në tjetrin. Studenti, i cili në përfundim të vitit akademik nuk merr 50% të lëndëve (së bashku me sesionin e vjeshtës), nuk kalon në vitin akademik pasardhës, por mbetet në stazh. Studenti detyrohet të frekuentojë lëndët e të rifutet në sesionet përkatëse të provimit. Studenti fiton të drejtën e mbrojtjes së diplomës (ose provim formimi), nëse ka shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura të programit mësimor.</p> <p>Shkalla e vlerësimit për përvetësimin e dijes nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 4 deri 10), me pikë ose me përqindje (100 pikë ose 100%) dhe me shkronja (sistemi ECTS me shkronjat nga A deri F). Notat kaluese konsiderohen nga 5 e lart, pikët nga 41 e lart dhe shkronjat nga A deri E.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion; 1.3 Rregullore Albanian University; 1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022; H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të</p>	<p>GVJ u informua se institucioni ka parashikuar procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Procedurat dhe kriteret për transferimin e studimeve dhe njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme gjenden në faqen web të AU si dhe në mënyrë më të detajuar në rregulloret përkatëse.</p>

<p>mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan dhe Zyra e Transferimeve dhe Ekuivalentimeve të Studimeve e cila funksionon bazuar në rregulloren përkatëse dhe operon në bashkëpunim me Departamentin. Kjo zyrë njeh studentët e interesuar me procedurat përkatëse për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve. Vendimarrja për këtë proces i takon Komisionit të Njohjes së Krediteve dhe Transferimit të Studimeve, i cili përcakton rast pas rasti njohjen e plotë, të pjesshme (me dobi formimi), si dhe vitin akademik në të cilin duhet të regjistrohet studenti.</p> <p>[Ev.: 1.3 Rregullore Albanian University; RVB; 2.5 Rregullore e regjistrimeve dhe transferimeve - VS 25 - dt. 25.06.2020 ]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë javës së parë të vitit akademik, Institucioni organizon ditët orientuese, gjatë të cilave, stafi akademik, stafi administrativ dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS) janë në dispozicion të studentëve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre, të tilla si kalendari akademik, orari mësimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambjentet mësimore etj. Gjithashtu informacione të përgjithshme jepen edhe në rregulloren e programit të studimit. GVJ konstatoi se në syllabuset e lëndëve janë paraqitur mënyrat e vlerësimit të dijeve. Elementë më të detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në seancën e parë, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve të syllabusit të lëndës dhe duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion; 2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 - 2023; H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në institucion, GVJ konstatoi se studentët informohen edhe për procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze diplome. Realizimi i tezës së diplomës drejtohet nga udhëheqësi i cili përcaktohet nga Departamenti, ndërsa tema e diplomës përcaktohet nga studenti në bashkëpunim me udhëheqësin. Departamenti gjithashtu</p>



	<p>përcakton dhe afishon grafikun e kontrollit të masës së realizimit të punës së temës së diplomës nga ana e studentit. Në rregullore përcaktohet edhe procedura e mbrojtjes së diplomës, ku vlerësimi përfundimtar jepet nga Komisioni i Diplomimit.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion; H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; 3.5.a Procedurë Diploma Master i Shkencave – v.a. 2021 - 2022; 3.5.b Shembull Procedurë Diplome MSc. IE – v.a. 2021 – 2022; 4.4 Tema diploma MSc. - 2018 - 2022; <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/leksion-i-hapur-punimi-i-temes-se-diplomes-keshilla-dhe-udhezime-do-te-zhvillohet-me-date-24-mentor-e-premte-ora-12-00-prane-salles-se-konferencave/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/leksion-i-hapur-punimi-i-temes-se-diplomes-keshilla-dhe-udhezime-do-te-zhvillohet-me-date-24-mentor-e-premte-ora-12-00-prane-salles-se-konferencave/</a> ]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>GVJ u informua se faqja web e AU si dhe kontaktet me stafin akademik luajnë një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve të ciklit të dytë për mundësinë e ndjekjes së ciklit të dytë në AU në të njejtin profil. Gjithashtu, referuar takimeve në institucion, GVJ konstatoi se pjesë e këtij informimi janë dhe ditët informuese organizuar nga institucioni. Në këtë proces kontribuon dhe Guida e Universitetit e cila jep informacione të përgjithshme mbi AU dhe mundësitë që ofrohen për ndjekjen e studimeve.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion; <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/dita-informuese-mbi-programet-master-te-ofruara-nga-departamenti-i-inxhinierive/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/dita-informuese-mbi-programet-master-te-ofruara-nga-departamenti-i-inxhinierive/</a>; <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/dita-informuese-mbi-programet-e-studimit-master-te-ofruara-nga-departamenti-i-inxhinierive/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/dita-informuese-mbi-programet-e-studimit-master-te-ofruara-nga-departamenti-i-inxhinierive/</a>; <a href="https://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2020/07/AU-University-GUIDA-2020-2021-.pdf">https://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2020/07/AU-University-GUIDA-2020-2021-.pdf</a> ]</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- GVJ konstatoi se studentëve u vihet në dispozicion një informacion i gjerë në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, elementët detyrues të tij si dhe kriteret e procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. GVJ evidentoi që burimet bazë të informimit janë rregulloret e institucionit (Rregullorja e AU; Rregullorja e FSHAE) si dhe Rregullorja e programit të studimit.</li> <li>- Institucioni ka parashikuar procedurat për njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme;</li> <li>- Gjatë javës së parë të vitit akademik, studentët informohen mbi procedurat e ndryshme që duhet të ndjekin për mbarëvajtjen e studimeve dhe mbrojtjen e temës së diplomës;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pedagogët u bëjnë të njohur syllabusin e lëndës duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit, mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse;</li> <li>- Faqja web e AU luan një rol të rëndësishëm në informimin e e studentëve mbi programin e studimit.</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	<p>Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se ata janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Gjatë javës së parë të vitit akademik, Institucioni organizon ditët orientuese, gjatë të cilave, stafi akademik, stafi administrativ dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS) janë në dispozicion të studentëve, duke i informuar mbi procedurat e ndryshme që ndjekin mbarëvajtjen e studimeve të tyre, të tilla si kalendari akademik, orari mësimor, frekuentimi, organizimi i klasave, grupeve, ambjentet mësimore etj.. Studentët informohen në mënyrë të detajuar edhe nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Një pjesë e informacionit, si orari mësimor, struktura mësimore, etj., është i aksesueshëm edhe nëpërmjet faqes së internetit të AU, si dhe nëpërmjet klasave virtuale të krijuara nga pedagogët (<i>MS Teams</i>).</p> <p>[Ev.: Takime në institucion;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/">https://albanianuniversity.edu.al/</a> ;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/kalendari-akademik-2/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/kalendari-akademik-2/</a>  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/</a> ]</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të	GVJ u informua se institucioni shpërndan informacion nëpërmjet faqes së internetit, Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, si dhe nëpërmjet pedagogëve të lëndëve. Në faqen e internetit gjendet e publikuar kurrikula si dhe kalendari akademik.

<p>posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Syllabuset, që çdo pedagog prezanton në fillim të lëndës, japin një informacion të detajuar e të qartë për përmbajtjen e lëndës, veprimtaritë formuese dhe kërkesat që studenti duhet të plotësojë për përparimin e tij akademik.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/kalendari-akademik-2/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/kalendari-akademik-2/</a>  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/</a> ;  2.1.b Syllabuse MSc. IE - v.a. 2022 – 2023;  3.4.c Udhezues video per perdorimin e platformes Microsoft Teams]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ konstatoi se një rol të veçantë në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit si dhe mbështetjen institucionale për orientimin në tregun e punës luan Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS), e cila ka për mision të orientojë, inkurajojë dhe të mbështesë studentët pranë AU për zhvillimin e tyre personal dhe profesional nëpërmjet aktivizimit në programe jashtë mësimore me karakter shkencor, profesional, social dhe kulturor në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Objektivi kryesor i kësaj zyre është të mbështesë studentët në përgatitjen e tyre më të mirë për punësim dhe të shërbejë në inkurajimin dhe zhvillimin e karrierës së tyre në fusha të caktuara studimi. ZKMS ofron shërbime për studentët e AU, të cilët kanë për qëllim orientimin e edukimit profesional, lehtësimin e zhvillimit të karrierës, përgatitjen për tregun e punës dhe mbështetje për të vazhduar aftësimin e tyre profesional nëpërmjet të mësuarit gjatë gjithë jetës. Kjo zyrë shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencial, me qëllim promovimin e studentëve të AU dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit.</p> <p>Në drejtim të punësimit kontribon dhe Zyra e Karrierës &amp; Alumnit, e cila shpërndan për studentët e diplomuar informacione mbi ofertat e tregut të punës, mundësinë e praktikave, intershipeve, kualifikimeve etj..</p> <p>GVJ u informua se institucioni organizon çdo vit panairin e punës ku studentët njihen me shumë mundësi trajnimi, intershipi dhe punësimi nga kompani të ndryshme të cilat i orientojnë ata për hapa të sigurtë drejt karrierës.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion;</p>

	<p><a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-koordinimit-dhe-mbeshtetjes-ndaj-studentit/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-koordinimit-dhe-mbeshtetjes-ndaj-studentit/</a> ;</p> <p><a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-karrieres-dhe-alumnit/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-karrieres-dhe-alumnit/</a> ;</p> <p><a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/panairi-i-punes-2023/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/panairi-i-punes-2023/</a> ]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni mundëson një shpërndarje të informacionit në shumë drejtime gjatë gjithë jetës universitare në mënyrë të vazhdueshme. Një rol të veçantë në këtë drejtim luan faja web e institucionit dhe sistemi <i>Pitagora</i>. Gjithashtu stafi akademik, ai administrativ dhe studentët disponojnë <i>email</i>-et zyrtare të Institucionit, bashkë me të cilët ofrohet paketa <i>Office 365</i>, aplikacionet e të cilës mundësojnë ruajtjen dhe shpërndarjen e informacionit, si dhe komunikimin interaktiv në kohë reale ndërmjet përdoruesve.</p> <p>Sekretaria mësimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve për rregjistrimet, pagesat, notat etj.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/">https://albanianuniversity.edu.al/</a> ;  <a href="https://au.pitagora.rash.al/">https://au.pitagora.rash.al/</a>;  3.2 Klasat <i>Microsoft Teams</i> - Departamenti i Inxhinierive;  Vizitë në Sekretarinë Mësimore]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>GVJ u informua se studentët mund të aksesojnë të gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit, vlerësimit, detyrave, orarit etj nëpërmjet faqes web të institucionit dhe nëpërmjet sistemit <i>Pitagora</i>, i cili ofron një akses të individualizuar në sistem dhe është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë. Gjithashtu, një pjesë e mirë e informacionit shpërndahet dhe i mundësohet aksesimi në distancë nëpërmjet platformës <i>Office 365 (MS Teams)</i>.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/">https://albanianuniversity.edu.al/</a> ;  <a href="https://au.pitagora.rash.al/">https://au.pitagora.rash.al/</a>;  3.2 Klasat <i>Microsoft Teams</i> - Departamenti i Inxhinierive]</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<p>- Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij;</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Një rol të rëndësishëm në informimin e vazhdueshëm të studentëve luan faqja web e institucionit;</li> <li>- Sekretaria mësimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve.</li> <li>- Një rol të veçantë në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët dhe Zyra e Karrierës &amp; Alumnit.</li> <li>- Sistemi i informacionit Pitagora, ofron një akses të individualizuar në sistem dhe është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë. Gjithashtu, një pjesë e mirë e informacionit shpërndahet dhe i mundësohet aksesimi në distancë nëpërmjet platformës Office 365 (MS Teams).</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.4</b>															
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</b>															
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>														
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	<p>Sekretaria mësimore e FSHAE është një nga strukturat më të rëndësishme për mbajtjen e statistikave për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Të dhënat përpunohen nga sekretaria mësimore dhe ruhen si në format fizik (regjistrat themeltar, regjistrat e lëshimit të diplomave) ashtu dhe në format elektronik. Gjithashtu të dhënat dhe statistikave mund të përpunohen edhe nga sistemi <i>Pitagora</i>.</p> <p>Numri i studentëve të diplomuar për këtë program studimi, në katër vitet e fundit akademike paraqitet si vijon:</p> <table border="1" style="margin-left: auto; margin-right: auto;"> <thead> <tr> <th>Programi i studimit</th> <th>Viti Akademik</th> <th>Numri total i të diplomuarve</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="4">Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike"</td> <td>2018-2019</td> <td>28</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>26</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>23</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>15</td> </tr> </tbody> </table>			Programi i studimit	Viti Akademik	Numri total i të diplomuarve	Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike"	2018-2019	28	2019-2020	26	2020-2021	23	2021-2022	15
Programi i studimit	Viti Akademik	Numri total i të diplomuarve													
Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike"	2018-2019	28													
	2019-2020	26													
	2020-2021	23													
	2021-2022	15													

	<p>GVJ zhvilloi edhe një vizitë në Sekretarinë Mësimore dhe konstatoi se plotësimi i regjistrimit themeltar dhe regjistrimit të lëshimit të diplomave janë në përputhje me standartet dhe udhëzimet e MAS.</p> <p>[Ev. Vizitë në Sekretarinë mësimore; Tabela Aneks RVB - MSc. IE]</p>																																
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbledhjen e informacionit dhe administrimin e dokumentacionit për çdo student që në momentin e regjistrimit të tij deri në përfundim të studimeve. Kjo strukturë administron të dhëna në lidhje me procedurat e transferimit dhe ç’regjistrimet që mund të ketë gjatë vitit akademik. Të dhënat në lidhje me studentët mbahen në formë elektronike (sistemi <i>Pitagora</i>) dhe në format letër. Të dhënat pasqyrohen në regjistrin themeltar të studentëve (i gjeneraliteteve dhe notave) dhe regjistrat e lëndëve. Për pesë vitet e fundit akademike rregjistrimet dhe transferimet për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" kanë qenë si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="549 994 1390 1442"> <thead> <tr> <th rowspan="2">Viti akademik</th> <th rowspan="2">Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë</th> <th colspan="2">Studentë të transferuar sipas viteve</th> <th rowspan="2">Totali</th> </tr> <tr> <th>I</th> <th>II</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2018-2019</td> <td>28</td> <td>0</td> <td>1</td> <td>29</td> </tr> <tr> <td>2019-2020</td> <td>31</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>31</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>17</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>17</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>22</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>22</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>20</td> <td>0</td> <td>0</td> <td>20</td> </tr> </tbody> </table> <p>Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit dhe e gjeti atë në përputhje me standartet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>[Ev. Vizitë në Sekretarinë mësimore; Tabela Aneks RVB - MSc. IE]</p>	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Studentë të transferuar sipas viteve		Totali	I	II	2018-2019	28	0	1	29	2019-2020	31	0	0	31	2020-2021	17	0	0	17	2021-2022	22	0	0	22	2022-2023	20	0	0	20
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë			Studentë të transferuar sipas viteve			Totali																										
		I	II																														
2018-2019	28	0	1	29																													
2019-2020	31	0	0	31																													
2020-2021	17	0	0	17																													
2021-2022	22	0	0	22																													
2022-2023	20	0	0	20																													
<p><b>Kriteri 3.</b> Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet</p>	<p>GVJ u informua se gjithë informacioni për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre disponohet nga Sekretaria mësimore. Këto të dhëna disponohen në format letër (në regjistrat përkatës) si dhe në sistemin <i>Pitagora</i>, ku hidhen të dhënat dhe ndiqet ecuria e studentëve përgjatë vitit akademik. Po ashtu, edhe vetë studentët mund të ndjekin ecurinë</p>																																




<p>të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>e tyre duke u informuar përmes sistemit të cilin kanë akses të personalizuar.</p> <p>[Ev. Vizitë në Sekretarinë mësimore; Takim me studentët; RVB]</p>						
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Veprimtaria e Sekretarisë mësimore mbështetet në rregulloren e AU dhe rregulloren e FSHAE. Neni 16 i rregullores përcakton se Sekretaria Mësimore e FSHAE është njësi ndihmëse dhe shërbimi, në funksion të procesit mësimor në Universitet. Ajo përgjigjet për organizimin dhe mirëfunksionimin e procesit të regjistrimeve, të transferimeve, të provimeve, për procesin e lëshimit të diplomave dhe mbajtjen e regjistrave të ndryshëm.</p> <p>Në nenet 17 dhe 18 të rregullores së FSHAE përcaktohen qartë detyrat e Kryesekretarit dhe Sekretarit Sekretarisë Mësimore. Në Rregullore përcaktohet se në çdo përfundim semestri, Kryesekretari paraqet pranë Dekanit të Fakultetit dhe Rektorit një raport të veçantë me të dhëna të detajuara mbi realizimin e detyrave dhe të situatës në përgjithësi të fushës që mbulon.</p> <p>Në nenin 21, pika 2-h të Statutit përcaktohet se Rektorati ushtron kontrolle tematike, të organizuara apo spontane në njësitë e Universitetit për përmbushjen e qëllimeve të tij, si dhe për zbatimin e akteve të organeve të AU.</p> <p>[Ev. Vizitë në Sekretarinë mësimore; 1.2 Statuti Albanian University; 1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022]</p>						
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Sekretaria mësimore e FSHAE dhe Departamenti i Inxhinierive disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Zyra e Karrierës &amp; Alumnit, e cila kontribuon në drejtim të punësimit të të diplomuarve, kujdeset dhe për krijimin e një database statistikash të punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve në AU.</p> <p>Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel institucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik. Të dhënat për cilësinë në hyrje paraqiten si vijon:</p> <table border="1" data-bbox="571 1809 1342 1957"> <thead> <tr> <th>Programi i studimit</th> <th>Viti Akademik</th> <th>Nota mesatare në hyrje</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td>2018-2019</td> <td>6.25</td> </tr> </tbody> </table>	Programi i studimit	Viti Akademik	Nota mesatare në hyrje		2018-2019	6.25
Programi i studimit	Viti Akademik	Nota mesatare në hyrje					
	2018-2019	6.25					



<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Neni 49 i Statutit të AU, përcakton funksionimin në institucion të Këshillit Studentor i cili është një organizëm i pavarur, që nuk zhvillon aktivitet politik dhe ekonomik. Këshilli Studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të AU, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Veç kësaj në anëtarët e Senatit Akademik përfshihet dhe një përfaqësues i studentëve (kryetari i Këshillit Studentor), duke mundësuar në këtë mënyrë transmetimin e zërit të tyre në këtë organ drejtues si dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje.</p> <p>Gjithashtu GVJ u informua se studentët përfaqësohen edhe në Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin, Komisionin për Vlerësimin Institucional, dhe Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimin.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion; 1.2 Statuti Albanian University; <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/keshilli-studentor/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/keshilli-studentor/</a>]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>AU garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin, Komisionin për Vlerësimin Institucional, Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimin si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm e përgatitjen e RVB.</p> <p>Gjithashtu, GVJ u informua se studentët marrin pjesë dhe në vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera nëpërmjet pyetsorëve ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësime për pedagogun;</li> <li>• Vlerësime për lëndën;</li> <li>• Vlerësime për infrastrukturën mbështetëse;</li> <li>• Vlerësime për stafin administrativ dhe Universitetin.</li> </ul> <p>Nga takimi me studentët GVJ konstatoi se ata ndihen të përfaqësuar nga Këshilli Studentor dhe të mbështetur për problematikat që hasin në AU.</p> <p>[Ev.: Takim me studentët;</p>

	<p>3.3 Shembull pyetësori në MF - MSc. IE - Viti I - Sem. I;          6.8.e Pyetjet për fokus grupet – Janar 2023;          6.9.f Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. I - v.a. 2021 - 2022;          6.9.g Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. II - v.a. 2021 - 2022]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Tërheqja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të AU. Gjithashtu, nëpërmjet pyetsorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët tërhiqet, ndërmjet të tjerash, mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin eventual të programit të studimit (ku studentit i jepet e drejta të japë mendimin e tij në formë sugjerimi si për lëndët mësimore ashtu dhe për pedagogun në kuadër të përmirësimit të tyre). Përpunimi i të dhënave të këtij pyetsori për çdo program studimi, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, mund të shërbejë si bazë për përmirësime të mëtejshme.</p> <p>GVJ gjatë takimeve në institucion u informua se elementë të përmirësimit të programit të studimit janë integruar në mënyrë të vazhdueshme në trajtën e përmirësimeve periodike të syllabuseve të lëndëve.</p> <p>[Ev.: Takim me studentët;          6.8.e Pyetjet për fokus grupet – Janar 2023;          6.9.f Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. I - v.a. 2021 – 2022;          2.6 Procedura e rishikimit të kurrikulave MSc. – 04.2021]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve, realizohet mbi bazën e procedurave të përcaktuara në rregulloret përkatëse. Këto procedura synojnë të garantohet barazia dhe ndershmëria e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentëve u njihet e drejta e ankimit. GVJ konstatoi se studentët e këtij programi studimi janë të informuar me procedurat dhe rregullat që duhet të ndjekin nëse dëshirojnë të ankimojnë një vlerësim. Në rregulloret studentit i njihet e drejta të bëjë kërkesë dhe ankesë kur mendon se vlerësimi për të nuk është i drejtë. Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit pas korrigjimit pasi të bëhet edhe ç’sekretimi i tyre. Ai ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë, si dhe me pikët në çdo rubrikë. Nëse studentit konstaton se ka rubrika të pakorrigjura apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë</p>



	<p>sekretarisë mësimore të programit të studimit përkatës, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve. Pas reklamimit të provimit nga ana e studentit Dekani i Fakultetit ngre një komision <i>ad hoc</i> në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë edhe pedagogët të cilët kanë korrigjuar provimet. Vendimi lidhur me rivlerësimin e provimit merret brenda një jave nga dita e depozitimit të ankesës dhe i bëhet i njohur studentit nëpërmjet sekretarisë mësimore.</p> <p>Nga takimet me studentët GVJ u informua se nuk ka patur problematika të evidentuara në lidhje me procesin e vlerësimit të tyre nga ana e pedagogëve.</p> <p>[Ev.: Takim me studentët; 1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022 H.1 Rregullore mesimore MSc. IE - 04.2021; 3.6 Format kerkese per rishikimin e tezes]</p>			
<b>Konkluzione</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në menaxhim dhe në vendimmarrje duke mundësuar përfaqësimin e tyre në Senat, Komisioni për Kurrikulat dhe Mësimin, Komisionin për Vlerësimin Institucional, Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimin si dhe në grupin e vlerësimit të brendshëm e përgatitjen e RVB;</i></li> <li>- <i>Studentët në AU janë të organizuar në Këshilla Studentore duke mundësuar shprehjen e mendimeve dhe paraqitjen e propozimeve për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit.</i></li> <li>- <i>Tërheqja e mendimit të studentëve për programin e studimit realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në organet vendimmarrëse të AU si dhe nëpërmjet përpunimit të pyetësorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët;</i></li> <li>- <i>Vlerësimi i dijeve, realizohet mbi bazën e procedurave të përcaktuara në rregulloret përkatëse të cilat garantojnë barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit. Studentëve u njihet e drejta e ankimit. Konstatohet se nuk ka patur problematika të evidentuara në lidhje me procesin e vlerësimit të studentëve nga ana e pedagogëve.</i></li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Standardi V.6**



<b>Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ u informua se në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në AU funksionojnë struktura dhe njësi të posaçme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët (ZKMS);</li> <li>- Zyra e Karrierës &amp; Alumnit;</li> <li>- Sekretaria Mësimore.</li> </ul> <p>ZKMS ka për mision të orientojë, inkurajojë dhe të mbështesë studentët pranë AU për zhvillimin e tyre personal dhe profesional nëpërmjet aktivizimit në programe jashtë mësimore me karakter shkencor, profesional, social dhe kulturor në përshtatje me kërkesat e tregut të punës. Objektivi kryesor i kësaj zyre është të mbështesë studentët në përgatitjen e tyre më të mirë për punësim dhe të shërbejë në inkurajimin dhe zhvillimin e karrierës së tyre në fusha të caktuara studimi. ZKMS ofron shërbime për studentët e AU, të cilët kanë për qëllim orientimin e edukimit profesional, lehtësimin e zhvillimit të karrierës, përgatitjen për tregun e punës dhe mbështetje për të vazhduar aftësimin e tyre profesional nëpërmjet të mësuarit gjatë gjithë jetës.</p> <p>GVJ konstaton se strukturat në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në AU janë aktive dhe janë ndërtuar e funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-koordinimit-dhe-mbeshtetjes-ndaj-studentit/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-koordinimit-dhe-mbeshtetjes-ndaj-studentit/</a> ]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sekretaria mësimore është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel fakulteti dhe ka për mision funksionimin, organizimin dhe shërbimin ndaj studentëve dhe stafit akademik. Departamenti gjithashtu ndjek përparimin e studentëve dhe e bën pjesë edhe të raporteve vjetore, shoqëruar me analizën përkatëse. Gjithashtu, nga takimi me studentët, GVJ u informua se një rol të rëndësishëm në drejtim të informimit, këshillimit dhe dhe asistimin të tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit luajnë dhe pedagogët e lëndëve të cilët janë të disponueshëm jo vetëm gjatë seancave mësimore, por edhe jashtë tyre duke shfrytëzuar komunikimet në rrugë elektronike.</p>

	<p>[Ev.: <i>Takime në institucion;</i>  <i>4.7 Rregullore e sekretarise mesimore;</i>  <i>1.1.e Raporti vjetor Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2021 – 2022]</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Karrierës &amp; Alumnit, kontribon në drejtim të punësimit të të diplomuarve, duke shpërndarë për studentët e diplomuar informacione mbi ofertat e tregut të punës, mundësinë e praktikave, intershipeve, kualifikimeve etj. Kjo zyrë organizon dhe takime mes studentëve të diplomuar me studentët aktualë me qëllim shkëmbimin e eksperiencave të punësimit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta.</p> <p>Departamenti, me mbështetjen e Zyrës së Karrierës &amp; Alumnit, orienton studentët në përzgjedhjen e institucionit, pranë të cilit do të zhvillojnë praktikën profesionale e cila zhvillohet kryesisht në institucionet me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>[Ev.: <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-karrieres-dhe-alumnit/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-karrieres-dhe-alumnit/</a>;  <i>Tabela Aneks RVB - MSc. IE (Tabela 5)</i>]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ u informua se Zyra e Karrierës &amp; Alumnit mundëson:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- administrimin e një database statistikash të punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve në AU;</li> <li>- dhënien e referencave për studime dhe punësim;</li> <li>- organizimin e takimeve mes studentëve të diplomuar me studentët aktual me qëllim shkëmbimin e eksperiencave të punësimit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta;</li> <li>- mbajtjen e kontaktit me studentët e diplomuar (Alumni) të cilët japin informacione në bazë të përvojës së tyre personale, këshillim karriere për studentët që janë aktualisht pjesë e tij dhe mbështetje në formimin e tyre profesional;</li> <li>- mbështetjen e AU nga studentët e diplomuar (Alumni) duke tërhequr vazhdimisht mendimin e tyre mbi hapat që duhet të ndërmerret AU, apo duke ndihmuar studentët aktualë në studimet e tyre dhe në zhvillimin e praktikës profesionale.</li> </ul> <p>[Ev.: <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-karrieres-dhe-alumnit/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-karrieres-dhe-alumnit/</a>;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/pyetesor-per-alumni/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/pyetesor-per-alumni/</a> ;  <i>Takime në institucion]</i></p>

<b>Konkluzione</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve në AU funksionojnë struktura dhe njësi të posaçme si Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, Zyra e Karrierës &amp; Alumnit, Sekretaria Mësimore.</li> <li>- Një rol të rëndësishëm në drejtim të informimit, këshillimit dhe dhe asistimin të tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit luajnë dhe pedagogët e lëndëve;</li> <li>- Zyra e Karrierës &amp; Alumnit, kontribon në drejtim të punësimit të të diplomuarve, duke shpërndarë për studentët e diplomuar informacione mbi ofertat e tregut të punës, mundësinë e praktikave, intershipeve, kualifikimeve etj..</li> </ul>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X


<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	GVJ konstatoi se FSHAE e zhvillon programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" në përputhje me standartet e vendosura nga AU dhe ato shtetërore të cilësisë, duke harmonizuar punën në auditor me punën individuale të studentit e duke shfrytëzuar gjithë materialet e vëna në dispozicion nga pedagogët si dhe materialet që ofron biblioteka (fizike dhe online). AU, bazuar në strukturën institucionale, ka të ngritur dhe ka funksionale Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila është e ndërvarur nga Rektorati dhe Senati Akademik ku dhe raporton veprimtarinë e saj. Kjo njësi së bashku me Komisionin e Vlerësimit Institucional dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave garantojnë sistemin e brendshëm të



	<p>Sigurimit të Cilësisë në AU. Funksionimi i këtyre organeve sanksionohet në rregulloret përkatëse.</p> <p>Nga takimet në institucion, GVJ u informua se personeli akademik ka në fokusin e tij përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në këtë drejtim kanë kontribuar mobilitetet e personelit akademik në universitete jashtë vendit.</p> <p>[Ev.: 6.10 Rregullore NJSBC;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/struktura-institucionale/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/struktura-institucionale/</a> ;  1.2 Statuti Albanian University;  1.3 Rregullore Albanian University;  1.6 Rregullore FSHAE - 20.04.2022]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive është përgjegjës për realizimin e procesit mësimor për programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike". Në këtë aspekt është dhe përgjegjësi kryesor për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies nga ana e personelit akademik. Kjo detyrë drejtohet nga Përgjegjësi i Departamentit. Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik drejtohet nga NJSBC. Kjo njësi koordinon realizimin e procesit të vetëvlerësimit të institucionit nëpërmjet mekanizmave përkatës (anketimi i studentëve 2 herë në vit, fokus grupet etj) dhe akteve të brendshme rregullatore. Në fillimin e vitit akademik, çdo anëtar i personelit akademik kryen parashikimin e ngarkesës vjetore e cila vlerësohet dhe miratohet nga përgjegjësi i Departamentit dhe Dekanati. Në fund të çdo semestri raportohet nga stafi akademik (PAE dhe PAK) mbi zhvillimin e procesit mësimor në lëndët përkatëse duke trajtuar elementë të tillë si qëllimet e kursit dhe si janë përmbushur ato, realizimin e programit, frekuentimin, literaturën e përdorur, përputhjen e rezultateve të marra në provim me qëllimet e kursit etj.</p> <p>GVJ konstatoi se këta elementë integrohen dhe në raportet vjetore të Departamentit të Inxhinierive, ku ndërmjet të tjerave trajtohen dhe elementë të tillë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Puna e pedagogëve e matur përmes raportit të vetëvlerësimit;</li> <li>- Puna e pedagogëve e matur përmes pyetësorëve të studentëve;</li> <li>- Puna e pedagogëve e matur nga drejtuesi i departamentit.</li> </ul> <p>[Ev.: 3.3 Shembull pyetësori në MF - MSc. IE - Viti I - Sem. I;  6.9.f Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. I - v.a. 2021 - 2022;</p>



	<p>6.9.g Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. II - v.a. 2021 – 2022;</p> <p>3.7.a Shembull raporti semestral PAE - MSc.;</p> <p>3.7.b Shembull raporti semestral PAK - MSc. IE;</p> <p>1.1.e Raporti vjetor Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2021 – 2022]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies e të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit, i cili plotësohet në fund të çdo semestri. Ky pyetësor është anonim dhe gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet nga NjSBC.</p> <p>Garantimi i ankimit të rezultatit të provimit bazohet në procedurën e përcaktuar në rregullore.</p> <p>[Ev.: Takim me studentët;</p> <p>3.3 Shembull pyetësori në MF - MSc. IE - Viti I - Sem. I;</p> <p>3.6 Format kerkese per rishikimin e tezes]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ u informua se të dhënat e pyetësorëve pasi përpunohen nga NjSBC i vihen në dispozicion Departamentit, i cili i diskuton në tërësi në mbledhjen e radhës. Rastet specifike, apo shqetësuese diskutohen personalisht me personat e interesuar. Vlerësimi personal i bëhet i ditur pedagogëve individualisht përmes postës elektronike dhe në Departament. GVJ konstatoi se këta elementë integrohen dhe në raportet vjetore të Departamentit të Inxhinierive.</p> <p>Një analizë përmbledhëse e pyetësorëve në nivel Universiteti bëhet objekt diskutimi dhe në mbledhjen e radhës së Senatit Akademik.</p> <p>GVJ konstatoi se elementë të caktuar bëjnë pjesë dhe në raportet vjetore të cilët publikohen në faqen web të institucionit.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion;</p> <p>6.9.f Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. I - v.a. 2021 - 2022;</p> <p>6.9.g Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. II - v.a. 2021 – 2022;</p> <p>1.1.e Raporti vjetor Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2021 – 2022;</p> <p><a href="https://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2020/07/R.Vjetor-AU-2021-2022.pdf">https://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2020/07/R.Vjetor-AU-2021-2022.pdf</a>]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe</p>	<p>GVJ konstatoi se një rol të madh në promovimin e shembujve të praktikave të mira, nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies luan NjSBC</p>

<p>rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>dhe Departamenti i Inxhinierive. Rezultatet përfundimtare të vlerësimeve janë objekt i diskutimeve në Departament dhe bëjnë pjesë në raportet vjetore të Departamentit të Inxhinierive ku pasqyrohen edhe elementë të vlerësimit të performancës së stafit akademik. Një element i rëndësishëm i raporteve vjetore të departamentit është dhe analiza SWOT e cila mundëson evidentimin e pikave të forta, pikave të dobta, mundësive dhe pengesave që lidhen me aktivitetin e Departamentit.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion; 1.1.c Raporti vjetor - DI - v.a. 2020 – 2021; 1.1.e Raporti vjetor Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2021 – 2022]</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Realizimi i programit studimit është në përputhje me standartet e shtetërore të cilësisë dhe ato të institucionit, duke harmonizuar punën në auditor me punën individuale të studentit dhe duke shfrytëzuar gjithë materialet e vëna në dispozicion nga pedagogët si dhe materialet që ofron biblioteka (fizike dhe online);</li> <li>- Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik drejtohet nga NjSBC;</li> <li>- GVJ konstatoi se garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies e të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetsorit të vlerësimit të stafit akademik të angazhuar në programin e studimit, i cili plotësohet në fund të çdo semestri;</li> <li>- Elementë të caktuar të vlerësimit integrohen dhe në raportet vjetore të Departamentit të Inxhinierive si dhe në raportet vjetore të institucionit të cilët publikohen në faqen web;</li> <li>- Rezultatet përfundimtare të vlerësimeve janë objekt i diskutimeve në Departament.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>


**Standarti VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
------------------------	--------------------------------------

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Në AU në strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Senati Akademik;</li> <li>- Komisionin e Vlerësimit Institucional;</li> <li>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC);</li> <li>- Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave;</li> <li>- Departamenti.</li> </ul> <p>Organizimi, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të cilësisë jepen në Statut (nenet 11, 25, 65, 66, 67, 81), Rregulloren për "Mbarrëvajtjen e kurrikulave dhe procesit mësimor" dhe Rregulloren për "Organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë". Këto struktura operojnë bazuar në "Strategjinë për Sigurimin e Cilësisë në AU".</p> <p>GVJ vëren se këto struktura janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p>[Ev.: 1.2 Statuti Albanian University; 6.6 Rregullore per mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor ne AU; 6.10 Rregullore NJSBC; 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 – 2025]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ konstatoi se AU ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë me Vendim Senati Akademik, nr. 178 dt. 23.07.2010, si dhe me Vendim Nr. 4 të Senatit Akademik dt. 22.12.2016 ka ngritur edhe Komisionin për Vlerësimin Institucional, pjesë e të cilit është edhe një student. Studentët, gjithashtu, janë të përfshirë si pjesë e grupeve të punës në rastet kur institucioni realizon akreditimin institucional apo akreditimin e programeve të studimit, si dhe gjatë realizimit të pyetësorëve. Gjithashtu, në nivel njësie bazë, është ngritur dhe funksionon grupi i sigurimit të cilësisë me Vendim Senati Akademik Nr. 157/3 dt. 08/09/2016, anëtarët e të cilëve përditësohen çdo vit. Politikat e sigurimit të cilësisë paraqiten në mënyrë të detajuar në Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. NjSBC në AU bashkëpunon edhe me ekspertë të jashtëm, të angazhuar pranë tij: 1 konsulent juridik dhe 1 konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave.</p> <p>GVJ konstatoi se këto struktura janë ndërtuar dhe funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale dhe, duke qenë aktive e të koordinuara,</p>


	<p>kontribuojnë në rritjen e vëmendjes ndaj cilësisë në realizimin e programit të studimit.</p> <p>[Ev.: 6.1 VS - krijimi i ZSBC - 23 07 2010; 6.2 VS - krijimi i KVI - 22 12 2016; 6.3.f Perfaqesuesit e SC - DI - v.a. 2022 – 2023; 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 – 2025; 6.5.a VB - E. Pano; 6.5.b VB - B. Kola ]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>NjSBC në AU koordinon realizimin e procesit të vetëvlerësimit të institucionit nëpërmjet instrumentave e mekanizmave dhe akteve të brendshme rregullatore. Ndër instrumentat dhe treguesit të përdorur mund të përmenden:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Trajnimi i stafit akademik;</li> <li>• Pyetsorët me studentët;</li> <li>• Fokus grupet.</li> </ul> <p>AU i nënshtrohet akreditimit të jashtëm periodik. Me vendim të Bordit të Akreditimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, përmes Vendim Nr. 55, datë 26.05.2023 AU i është dhënë një vlerësim pozitiv për cilësinë akademike me një kohëzgjatje prej 4 vitesh (deri më 25.05.2027).</p> <p>Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Inxhinieri Elektronike” është liçensuar përmes Urdhërit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.411, datë 25.08.2011 si dhe është akredituar (akreditimi periodik) VBA Nr. 83, datë 27.10.2018 me vlefshmëri deri më 30.9.2023.</p> <p>[Ev.: 3.1.c Axbenda e trajnimeve të stafit akademik - v.a. 2022 – 2023; 3.3 Shembull pyetësori në MF - MSc. IE - Viti I - Sem. I; 6.8.d Fokus Grupe – 2022; 6.8.e Pyetjet për fokus grupet – Janar 2023; <a href="https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-26-maj-2023">https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-26-maj-2023</a>; <a href="https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-27-tetor-2018">https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-27-tetor-2018</a> ]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes,</p>	<p>GVJ u informua se NjSBC në mënyrë periodike zhvillon anketime me studentët për vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera nëpërmjet pyetsorëve ku përfshihen:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësime për pedagogun;</li> <li>• Vlerësime për lëndën;</li> </ul>



<p>arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësime për infrastrukturën mbështetëse;</li> <li>• Vlerësime për stafin administrativ dhe Universitetin.</li> </ul> <p>Gjithashtu, nga ana e personelit akademik hartohen raportet e vetëvlerësimit (raporte semestrale). GVJ konstatoi se këta elementë integrohen dhe në raportet vjetore të Departamentit të Inxhinierive, ku ndërmjet të tjerave trajtohen dhe elementë të tillë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Puna e pedagogëve e matur përmes raportit të vetëvlerësimit;</li> <li>- Puna e pedagogëve e matur përmes pyetësorëve të studentëve;</li> <li>- Puna e pedagogëve e matur nga drejtuesi i departamentit.</li> </ul> <p>Një element i rëndësishëm i raporteve vjetore të departamentit është dhe analiza SWOT e cila mundëson evidentimin e pikave të forta, pikave të dobta, mundësive dhe pengesave që lidhen me aktivitetin e Departamentit.</p> <p>GVJ konstatoi se Departamenti i Inxhinierive mbështetur nga NjSBC është aktiv në të gjithë veprimtarinë e Institucionit duke qenë nxitës dhe garantues i standardeve të cilësisë.</p> <p>[Ev.: 3.3 Shembull pyetësori në MF - MSc. IE - Viti I - Sem. I; 6.9.f Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. I - v.a. 2021 - 2022; 3.7.a Shembull raporti semestral PAE - MSc.; 3.7.b Shembull raporti semestral PAK - MSc. IE; 1.1.e Raporti vjetor Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2021 – 2022]</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Organizimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në AU garantohet nëpërmjet strukturave të ngritura në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale;</li> <li>- Në AU funksionon NjSBC në nivel institucioni, ndërsa në nivel njësie bazë është ngritur dhe funksionon grupi i sigurimit të cilësisë;</li> <li>- NJSBC në mënyrë periodike zhvillon pyetësorë me studentët me qëllim vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin;</li> <li>- Departamenti i Inxhinierive mbështetur nga NjSBC është aktiv në të gjithë veprimtarinë e Institucionit duke qenë nxitës dhe garantues i standardeve të cilësisë.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<b>Standardi VI.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Mbikëqyrja e periodike e programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" bazohet në vjeljen e informacionit nëpërmjet pyetsorëve që plotësohen në fund të çdo semestri e që i kushtohen vlerësimit të lëndëve të programit të studimit dhe personelit akademik.</p> <p>Departamenti i Inxhinierive shqyrton veprimtarinë mësimore duke kryer analiza vjetore të realizimit të procesit mësimor, punës administrative dhe asaj kërkimore shkencore në të cilat shqyrtohen problematikat e hasura dhe hapat konkrete në drejtim të përmirësimit.</p> <p>GVJ konstaton se në këtë aspekt operohet në përputhje me udhëzimet dhe standardet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion; 3.3 Shembull pyetësori në MF - MSc. IE - Viti I - Sem. I; 6.9.f Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. I - v.a. 2021 - 2022]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>GVJ u informua se nga ana e personelit akademik hartohen raportet e vetëvlerësimit (raporte semestrale). Në këto raporte trajtohen elementë të tillë si qëllimet e kursit dhe si janë përmbushur ato, realizimi i programit, frekuentimi, literatura e përdorur, përputhja e rezultateve të marra në provim me qëllimet e kursit, propozimet për përmirësim etj.</p> <p>GVJ konstatoi se këta elementë janë pjesë e analizave vjetore të Departamentit të Inxhinierive ku integrohet analiza e:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programeve të studimit;</li> <li>- Stafit akademik;</li> <li>- Mësimdhënies dhe Studentëve;</li> <li>- Infrastrukturës;</li> <li>- Financimit;</li> <li>- Kërkimit Shkencor;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Bashkëpunimit brenda dhe jashtë vendit;</li> <li>- Aplikimit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare;</li> <li>- Mobilitetit të stafit dhe studentëve;</li> <li>- Masave të marra për përmirësimin e pikave të dobta të departamentit.</li> </ul> <p>Mbi këtë bazë, në nivel Departamenti hartohen raporte semestrale dhe vjetore, ndërsa në nivel institucioni përpilohen raporte të cilat i transmetohen MAS.</p> <p>[Ev.: 3.7.a Shembull raporti semestral PAE - MSc.; 3.7.b Shembull raporti semestral PAK - MSc. IE; 1.1.e Raporti vjetor Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2021 – 2022; 1.1.d Raporti Sem. I - DI - v.a. 2021 – 2022; <a href="https://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2020/07/R.Vjetor-AU-2021-2022.pdf">https://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2020/07/R.Vjetor-AU-2021-2022.pdf</a>]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Nga analiza e DVV dhe nga vizita në institucion GVJ konstatoi se AU për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit operon me metoda të ndryshme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetsorë të studentëve (2 herë në vit);</li> <li>- Fokus grupe (në muajin Janar) mbi vlerësimin e procesit mësimor, infrastrukturës etj.;</li> <li>- Raporte vetëvlerësimi të personelit akademik (PAE dhe PAK);</li> <li>- Raporte semestrale e vjetore të Departamentit të Inxhinierive.</li> </ul> <p>Në raportet semestrale e vjetore të Departamentit përfshihen dhe statistika mbi kalueshmërinë e studentëve, notën mesatare, elementë të rishikimit të syllabuseve të lëndëve, planit mësimor etj.</p> <p>[Ev.: 3.3 Shembull pyetësori në MF - MSc. IE - Viti I - Sem. I; 6.8.d Fokus Grupe – 2022; 6.8.e Pyetjet për fokus grupet – Janar 2023; 3.7.a Shembull raporti semestral PAE - MSc.; 3.7.b Shembull raporti semestral PAK - MSc. IE; 1.1.e Raporti vjetor Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2021 – 2022]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të</p>	<p>Studentëve u mundësohet të jenë pjesëmarrës aktivë në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit edhe duke ofruar mendimet e</p>





<p>realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>tyre nëpërmjet përfshirjes në procesin e vlerësimin të programit të studimit (pjesë e GVB), Këshillit Studentor, pjesëmarrjes në Senatin Akademik, pjesëmarrjes në Komisionin për Kurrikulat dhe Mësimin, Komisionin për Vlerësimin Institucional si dhe në Komisionin për Kërkimin Shkencor dhe Botimin.</p> <p>GVJ u informua se Zyra e Karrierës &amp; Alumnit, ndërmjet të tjerash, mundëson administrimin e një database statistikash të punësimit të studentëve pas përfundimit të studimeve në AU e cila shërben si një bazë e mirë për vlerësimin e shkallës së përgatitjes profesionale të studentëve të diplomuar. Veç kësaj kjo zyrë organizon takime mes studentësh të diplomuar me studentët aktualë me qëllim shkëmbimin e eksperiencave të punësimit dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta si dhe organizon pyetsorë me studentët e diplomuar dhe eventualisht të punësuar. Një aspekt tjetër është dhe mbështetja e AU nga studentët e diplomuar (Alumni) duke tërhequr vazhdimisht mendimin e tyre mbi hapat që duhet të ndërmarë AU, apo duke ndihmuar studentët aktualë në studimet e tyre dhe në zhvillimin e praktikës profesionale.</p> <p>[Ev.: 5.5 Rregullore e Zyres se Karrieres dhe Alumnit;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-karrieres-dhe-alumnit/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-karrieres-dhe-alumnit/</a>;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/pyetesor-per-alumni/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/pyetesor-per-alumni/</a> ;  Takime në institucion]</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- GVJ konstaton se ndiqen dhe zbatohen të gjithë udhëzimet dhe standartet e përcaktuara në aktet përkatëse ligjore e nënligjore për mbikëqyrjen periodike të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike";</li> <li>- Nga ana e personelit akademik hartohen raportet e vetëvlerësimit, nga ana e Departamentit hartohen raporte semestrale dhe vjetore, ndërsa në nivel institucioni përpilohen raporte të cilat i transmetohen MAS;</li> <li>- Procesi i vlerësimit dhe përmirësimit të programit të studimit bazohet në informacione të përfuara nëpërmjet pyetsorëve të studentëve, fokus grupeve dhe kontakteve me Alumni.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<b>Standardi VI.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se AU për të garantuar politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisionin për Vlerësimin Institucional dhe në nivel njësie bazë, është ngritur dhe funksionon grupi i sigurimit të cilësisë. Gjithë procesi funksionon bazuar në rregulloret përkatëse si dhe në Strategjinë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë. GVJ u informua se NjsBC në AU bashkëpunon edhe me ekspertë të jashtëm, të angazhuar pranë tij: 1 konsulent juridik dhe 1 konsulent për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave.</p> <p>[Ev.: 6.1 VS - krijimi i ZSBC - 23 07 2010; 6.2 VS - krijimi i KVI - 22 12 2016; 6.3.f Perfaqesuesit e SC - DI - v.a. 2022 – 2023; 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 – 2025; 6.5.a VB - E. Pano; 6.5.b VB - B. Kola ]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Organizimi, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të cilësisë jepen në Statut (nenet 11, 25, 65, 66, 67, 81), Rregulloren për "Mbarrëvajtjen e kurrikulave dhe procesit mësimor" dhe Rregulloren për "Organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë". Këto struktura operojnë bazuar në "Strategjinë për Sigurimin e Cilësisë në AU". Këto struktura janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale dhe përcaktojnë përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>[Ev.: 1.2 Statuti Albanian University; 6.6 Rregullore per mbarevajtjen e kurrikulave dhe procesit mesimor ne AU; 6.10 Rregullore NJSBC; 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 – 2025]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet</p>	<p>Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" është garantuar përmes një procesi gjithëpërfshirës. Nga takimi me GVB, u konstatua se ka</p>

<p>të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm luajnë dhe pyetsorët e studentëve, fokus grupet si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të studentëve në instanca të ndryshme konsultative e vendimmarrëse. Nga takimi me GVB, u konstatua se për hartimin e RVB dhe plotësimin e DVV ka patur një koordinim të mirë të të gjithë instancave drejtuese dhe pjesëmarrje aktive të stafit akademik, studentëve etj. për të mundësuar një vlerësim real të programit të studimit me qëllim jo vetëm përmbushjen e detyrimit ligjor, por edhe për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së programit.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion; RVB; 6.8.e Pyetjet për fokus grupet – Janar 2023; 6.9.f Rezultatet e pyetesoreve drejtuar studenteve Sem. I - v.a. 2021 – 2022]</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Plotësimi i pyetsorëve nga ana e studentëve bëhet duke ruajtur anonimitetin. Gjithashtu anëtarët e personelit akademik informohen individualisht nëpërmjet postës elektronike në lidhje me rezultatet respektive të përfuara nga pyetsorët e studentëve. Në punën e saj NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie. GVJ nuk gjeti praktika të prekjes së integritetit apo ankimimit në lidhje me procesin në përgjithësi si dhe anketimet e kryera në veçanti.</p> <p>[Ev.: 1.2 Statuti Albanian University; 6.10 Rregullore NJSBC; 6.11 Kodi i Etikes; 6.4 Strategjia per Sigurimin e Cilesise 2022 – 2025]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe takimet në institucion, rezulton që në aspektin e aktivizimit, si pjesë e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të aktorëve të jashtëm institucioni organizon çdo vit panairin e punës. Gjithashtu mobilitetet Erasmus+ kanë ndihmuar në procesin e përmirësimit të cilësisë së programit të studimit.</p>

<p>programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Gjithashtu, organizohen edhe leksione të hapura me të ftuar nga jashtë institucionit si dhe angazhohen ekspertë të jashtëm për zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulave.</p> <p>[Ev.: Takime në institucion;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/panairi-i-punes-2023/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/panairi-i-punes-2023/</a> ;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/leksionin-e-hapur-on-line-inteligjenca-artificiale-design-2/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/leksionin-e-hapur-on-line-inteligjenca-artificiale-design-2/</a> ;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/leksion-i-hapur-disenjimi-dhe-konstruktimi-i-dores-robotike-te-komanduar-per-levizje-te-ndryshme/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/leksion-i-hapur-disenjimi-dhe-konstruktimi-i-dores-robotike-te-komanduar-per-levizje-te-ndryshme/</a> ;  2.10 Ngritja e GE për rishikimin e kurrikulave MSc. – 04.2021]</p>			
<p><b>Konkluzione</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Për të garantuar politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë AU ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisionin për Vlerësimin Institucional dhe në nivel njësie bazë, grupin e sigurimit të cilësisë;</li> <li>- Vlerësimi dhe sigurimi i cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" është garantuar përmes një procesi gjithëpërfshirës;</li> <li>- NJSBC zbaton gjithmonë parimin e ruajtjes së integritetit akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi dhe pabarazie;</li> <li>- Panairi i Punës, mobilitetet Erasmus+ si dhe leksione të hapura, kanë kontribuar në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë të programit të studimit.</li> </ul>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p><b>Standardi VI.5</b>  <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit</p>	<p>GVJ konstatoi se transparenca e veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit sigurohet nëpërmjet publikimit në faqen web të institucionit të elementëve që kanë të bëjnë me këtë proces (Statut, Rregullore e AU, Kodi i Etikës, Strategjia e Zhvillimit Institucional etj.) si dhe Raporte vjetore të institucionit, Raporte Vetëvlerësimi për Akreditimin Institucional,</p>

<p>janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Politikat e Kërkimit Shkencor, Vendimmarrje të Bordit të Administrimit etj.</p> <p>[Ev.: <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/statuti/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/statuti/</a> ;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/kodi-i-etikes/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/kodi-i-etikes/</a> ;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/strategjia-e-zhvillimit-institucional/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/strategjia-e-zhvillimit-institucional/</a> ;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/rregullore/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/rregullore/</a>  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/politikat-e-kerkimit-shkencor/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/politikat-e-kerkimit-shkencor/</a> ;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/vendimmarrje-te-bordit-te-administrimit/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/vendimmarrje-te-bordit-te-administrimit/</a> ;  <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/rregullore-per-funksionimin-e-sistemit-te-kerkimit-shkencor-dhe-botimeve-akademike-ne-albanian-university/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/rregullore-per-funksionimin-e-sistemit-te-kerkimit-shkencor-dhe-botimeve-akademike-ne-albanian-university/</a> ]</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Anëtarët e personelit akademik informohen individualisht në lidhje me rezultatet respektive të përfuara nga pyetsorët e studentëve të cilat lidhen drejtëpërdrejt me performancën e tyre. GVJ konstatoi se informacionet e publikuara në faqen web të institucionit respektojnë lirinë akademike si edhe ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, ndryshuar me ligjin nr.48/2012 dhe ligjin nr.120/2014 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke garantuar ruajtjen e konfidencialitetit.</p> <p>[Ev.: <i>Takime në institucion</i>]</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive shqyrton veprimtarinë mësimore duke kryer analiza vjetore të realizimit të procesit mësimor, punës administrative dhe asaj kërkimore shkencore në të cilat shqyrtohen problematikat e hasura dhe hapat konkrete në drejtim të përmirësimit. Gjithashtu, GVJ është i mendimit se, adresimi i problematikave të konstatuara gjatë hartimit të RVB dhe të dala gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm dhe Vendimit të Bordit të Akreditimit për akreditimin institucional, konfirmojnë angazhimin e institucionit në këtë drejtim. Gjatë hartimit të RVB merren në konsideratë dhe rekomandimet e Bordit të Akreditimit të paraqitura gjatë vendimarrjes lidhur me vlerësimin periodik të programit.</p> <p>[Ev.: <i>Takime në institucion;</i>  <i>RVB;</i>  <i>1.1.c Raporti vjetor - DI - v.a. 2020 – 2021;</i>  <i>1.1.e Raporti vjetor Departamenti i Inxhinierive – v.a. 2021 – 2022]</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton përpjekje nga ana e AU në lidhje me efektivitetin e procesit të vlerësimit të brendshëm të cilësisë në programin e studimit. Angazhimi i të gjithë hallkave në këtë proces është shprehje e qartë e vëmendjes që ky institucion i jep këtij procesi. Përfshirja e rezultateve të vlerësimit në analizat si në nivel Departamenti ashtu edhe në nivel institucioni dëshmojnë për një proces me kontribut thelbësor në përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>[Ev.: <i>RVB;</i> <i>Takime në institucion</i>]</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni në fillim të çdo viti akademik, si dhe pas çdo procesi të vlerësimit të jashtëm, informon studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit.</p> <p>Vetë procesi i realizimit të anketimeve nëpërmjet pyetsorëve kontribon në informimin dhe ndërgjegjësimin e studentëve për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Gjithashtu AU organizon dhe trajnime qëllim rritjen e rolit të personelit akademik në performimin e standardeve të cilësisë së institucionit.</p> <p>[Ev.: <i>Takime në institucion;</i> <i>RVB;</i> <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/trajnim-i-organizuar-nga-njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-me-teme-rol-i-personelit-akademik-ne-rritjen-e-cilesise-se-arsimit-te-larte/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/trajnim-i-organizuar-nga-njesia-e-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-me-teme-rol-i-personelit-akademik-ne-rritjen-e-cilesise-se-arsimit-te-larte/</a> ; <a href="https://albanianuniversity.edu.al/sq/trajnimi-i-stafit-akademik/">https://albanianuniversity.edu.al/sq/trajnimi-i-stafit-akademik/</a> ]</p>
<p><b>Konkluzione</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Transparenca e veprimtarive në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit sigurohet nëpërmjet publikimit në faqen web të institucionit të elementëve që kanë të bëjnë me këtë proces;</i></li> <li>- <i>Anëtarët e personelit akademik informohen individualisht në lidhje me rezultatet respektive të përfuara nga pyetsorët e studentëve të cilat lidhen drejtëpërdrejt me performancën e tyre. Informacioni me rezultatet e vlerësimeve respektojnë lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale;</i></li> <li>- <i>Problematikat që rezultojnë bëhen objekt i trajtimit nga Departamenti, duke i pasqyruar në raportet vjetore dhe duke propozuar hapa konkretë në drejtim të përmirësimit;</i></li> </ul>

	- Anketimet e realizuar me studentët, hartimi i RVB dhe grumbullimi i informacionit për DVV si dhe trajnimet e organizuara me personelin akademik kontribuojnë në informimin dhe ndërgjegjësimin për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në  
"Inxhinieri Elektronike" Universiteti Privat "Albanian University"**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike" është në përputhje me interesat kombëtare, me qëllimet dhe misionin, si dhe me fushën e veprimtarisë akademike të "Albanian University";
2. Institucioni disponon infrastrukturën e nevojshme për realizimin me cilësi të programit të studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike";
3. Përbajtja dhe organizimi në module/lëndë në Programin e studimit Master i Shkencave në "Inxhinieri Elektronike", krijon mundësinë e formimit profesional të studentëve si ndërthurje e njohurive teorike dhe praktike të nevojshme, në përputhje me teknologjitë më të fundit të fushës duke mundësuar integrimin e tyre të shpejtë në tregun e punës;
4. Departamenti i Inxhinierive nxit dhe mbështet stafin akademik në zhvillimin e mësimdhënies me metoda bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, në përshtatje me tregun e punës duke e bërë programin tërheqës për studentët;
5. Departamenti i Inxhinierive mbështetur nga NJSBC është aktiv në të gjithë veprimtarinë e Institucionit duke qenë nxitës dhe garantues i standardeve të cilësisë.

**Pika të dobta**

1. Mbështetja financiare për kërkimin shkencor nga institucioni mbetet relativisht e ulët (**Standardi II.6, Kriteri 4**);
2. Në një numër të konsiderueshëm rastesh ka një mbingarkesë të theksuar të personelit akademik efektiv (**Standardi IV.1, Kriteri 2**).

**Rekomandime**

1. Rekomandohet që institucioni të rrisë përpjekjet për shtimin e marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadrin e bashkëpunimit evropian.
2. Rekomandohet që institucioni të shtojë më tej përpjekjet për rritjen e të ardhurave nëpërmjet granteve të projekteve kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare si dhe prej shërbimeve trainuese (kualifikimit të vazhdueshëm).
3. Me qëllim uljen e ngarkesës mësimore të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi në kufijtë e përcaktuar nga aktet nënligjore, institucioni duhet të gjejë mekanizmat e duhur për rekrutimin e personelit akademik suplementar me kohë të plotë, me grada e tituj.
4. Rekomandohet të përfundojë kodifikimi i lëndëve për këtë program studimi.



**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Master of Sciences in  
"Electronic Engineering" provided by the Higher Education Institution " Albanian  
University "**

**Strengths and affirmations**

1. The study program of the second cycle Master of Science in "Electronic Engineering" is in accordance with national interests, with the goals and mission, as well as with the field of academic activity of "Albanian University";
2. The institution has the necessary infrastructure for the quality implementation of the Master of Science study program in "Electronic Engineering";
3. The content and organization into modules/subjects of the Master of Science study program in "Electronic Engineering" create the possibility of professional training of students in the form of a combination of the necessary theoretical and practical skills, in accordance with the development of the latest technologies in the field, allowing their rapid integration into the labor market;
4. The Department of Engineering encourages and supports academic staff in developing teaching with contemporary methods, in accordance with the curriculum, in adaptation to the job market, thus making the program attractive to students;
5. The Engineering Department, supported by the Internal Quality Assurance Unit, is active in all activities of the Institution, being promoter and guarantor of quality standards.

**Weaknesses**

1. The financial support from the institution for scientific research remains relatively low (Standard II.6, Criteria 4);
2. In a significant number of cases, there is a marked overload of teaching hours by full-time academic staff (Standard IV.1, Criteria 2).

**Recommendation**

1. It is recommended that the institution increase its efforts to add international agreements within the framework of European cooperation;
2. The institution is recommended to further increase its efforts to increase its income through grants for national and international scientific research projects as well as through training services (continuing qualification);
3. In order to reduce the teaching load of the academic staff engaged in this study programme to the limits defined by the regulations, the institution must find appropriate mechanisms for the recruitment of additional full-time academic staff, with academic degrees and titles;
4. It is recommended to complete the codification of subjects for this study program.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

